



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 204/21

Nr. i fq. / Br. st -1-

Data: / Datum 17. 09. 2021

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 45.1 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë dhe nenit 6.3 të Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës dhe Organeve të Tij, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

I u f t o n

Të merrni pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet më datë **24 shtator 2021 (e premte) me fillim në ora 14:00. Mbledhja do të mbahet në objektin e shkollës së mesme - Gjimnazi "Eqrem Çabej" në Vushtrri në njërin nga sallat.**

Për këtë mbledhje propozohet ky:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, mbajtur më 29 korrik 2021;
2. Shqyrtimi i Draft-buxhetit dhe planeve investuese të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2020;
3. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko-financiare dhe zbatimin e planeve investuese për periudhën janar-qershor 2021;
4. Rishikimi i Planit të veprimit për të gjeturat e Auditorit;
5. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ofrimin e përkrahjes financiare për Klubin e Hendbollit "Vushtrria";
6. Të ndryshme.

Bashkëngjitur me ftesë iu dërgojmë rekomandimet e KPF-së dhe materialet për pikat e rendit të ditës.

Nasuf Aliu

Kryesues i Kuvendit





REPublika e Kosovës - Republika Kosovo
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUČITRN

01 Nr. / Br 203/21

Nr. i fq. / Br. st -1-

Data: / Datum 17. 09. 2021

VUSHTRRI, VUČITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI
OPŠTINA VUČITRN

PËR/ZA/TO:	Kuvendin e komunës
NGA/OD/FROM:	Nasuf Aliu  Kryesues i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Sekretarisë së kuvendit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, nga mbledhja e datës 16.9.2021

Në mbështetje të nenit 52, paragrafit 2 të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 54, paragrafit 5 të Statutit të Komunës dhe nenit 5, paragrafit 1, nënparagrafi 5 i Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 03/2014 për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme në Komunë, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më **16 shtator 2021** ka shqyrtuar këto materiale dhe nxori këto rekomandime:

1. Shqyrtimi i draft- buxhetit dhe planeve investuese për vitin 2022.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të përmirësohen disa gabime teknike dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
2. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko- financiare dhe zbatimin e planeve investuese për periudhën janar-qershor 2021.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
3. Rishikimi i Planit të Veprimit për të gjeturat e Auditorit.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
4. Shqyrtimi i kërkesës së Ymer Ukiqit.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet në drejtorinë kompetente.*
5. Propozim vendim për përkrahje financiare për klubin e hendbollit "Vushtrria"
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që së bashku me kërkesën e klubit dhe arsyetimin nga drejtoria të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVË



KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E -VII- E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË
VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 29 KORRIK 2021

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë duke filluar në orën 10:20.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

Abdullah Vojvoda, Agim Bregaj, Ali Januzi, Arta Ymeri, Agim Krasniqi, Basri Menxhiqi, Bahrije Ademi Murati, Fatmire Saraçi, Ermal Lahu, Fakete Dushi, Faton Shabani, Gresa Muli, Gentiana Rama, Habibe Gërzhaliu, Ilmi Azemi, Ilir Krasniqi, Fitim Halili, Ismet Hajrizi, Kushtrim Hyseni, Hajriz Mustafa, Lorik Maxhuni, Mehdi Bejtullahu, Mejreme Ismajli, Miljan Bojković, Nasuf Aliu, Nezir Klinaku, Nurtene Çerkezi-Gyshinca, Sajdie Bajgora, Selim Rrustemi, Melihate Basholli-Latifi, Suzana Syla, Shkëlzen Feka, Teuta Aruçi Shartari dhe Ymer Haradinaj.

Mungoi: Shpëtim Zhegrova.

Në fillim të mbledhjes kuvendi i Komunës së Vushtrrisë nderoi me një minutë heshtje luftëtarin e lirisë ish punëtorin e komunës të ndjerin Blerim Zhabari.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës z.Xhafer Tahiri, nënkryetari i komunës z.Afrim Namani, drejtorët e drejtorive komunale, përfaqësuesit e KFOR-it dhe zyrtar tjerë kompetent komunal.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu – kryesues i kuvendit, i cili konstatoi se në sallë janë të pranishëm 34 anëtarë të kuvendit, kuorum ky i mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrjen e vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-adresoï shqetësimin e qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë, për mbingarkesën në komunikacion, dhe për vonesat e mëdha që po iu shkaktohen qytetarëve nga lëvizja e ngadaltë e mjeteve motorike dhe bllokadave në rrugën magjistrale. Lidhur me këtë ai kërkoi nga policia e Kosovës që të vendos policë në rrethrotullime dhe udhëkryqe të rrugës magjistrale, me qëllim që tu jepet drejtim automjeteve ashtu që të zvogëlohen pritjet e mëdha të qytetarëve nëpër kolona. Ai shprehu nevojën që të kemi një plan për dhënë zgjidhjen e kësaj problematike nga ana e organeve të rendit. Pastaj shtoi se si rrugë alternative po shfrytëzohet rruga Nedakoc-Vushtrri, por në atë rrugë ka të vendosur shumë pengesa në modelin polic i shtritë, por të këto nuk janë të shenjzuar, andaj kërkoi nga Drejtoria e Shërbimeve Publike që të vendosin këto shenja me ngjyrë. Ndërsa ka probleme edhe me urën e Pestoves, ku qarkullimi mbi atë urë është jashtëzakonisht i vështirësuar, andaj edhe pse ky projekt është financuar nga qeveria e Kosovës, komuna duhet të gjej një zgjidhje që kyçja në atë urë të bëhet më e lehtë.

Gresa Muli, anëtare e kuvendit-adresi shqetësimin e saj dhe të qytetarëve, lidhur me punimet që po zhvillohen në rrugën “Hasan Prishtina” punime këto që po zhvillohen në një kohë jashtëzakonisht të papërshtatshme, kjo për faktin se në këto kohë çdoherë ka mbingarkesë të komunikacionit për shkak të ardhjes së bashkatdhetarëve tanë dhe si rezultat i rrugëve të ngushta, është krijuar një tollovi e madhe në qytet, kjo po ashtu i ka dëmtuar edhe bizneset përgjatë asaj rruge.

Habibe Gërxhaliu, anëtare e kuvendit-ngriti shqetësimin e qytetarëve të rrugës “Galip Badivuku” afër çerdhes së qytetit konkretisht në objektin banesor “Melosi” ku para ca ditësh ka ndodhur një zjarr në ç’ rast është djegur një lokal për këtë problematikë janë njoftuar policia, KEDS-i, komuna. Por banoret në atë objekt jo vetëm që janë mbetur për gjatë ditë pa rrymë por ata janë marr vetë me atë problem duke i blerë vetë kabllot e rrymës elektrike, ndërsa shumë banorë në këtë objekt jetojnë me asistencë sociale. Andaj lidhur me këtë problematikë ajo pyeti kryetarin e komunës, se a ka qenë në vizitë tek këtë banor dhe se a është marr konkretisht me hallet e këtyre banorëve.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-pasi përshëndeti të pranishmit vlerësoi se ish-koalicioni i gjerë qeverisës (LDK-VV-AKR-AAK-NS-LS më vonë edhe PD) kishin guximin dhe nuk turpëroheshin fare për dëmtimin e interesave të qytetarëve, bile bile edhe krenoheshin për kinse ndryshimin në Vushtrri. Pajtohem që ishte ndryshim por fatkeqësisht për të keq. Në anën tjetër çfarë bëri opozita (PDK-LB), nuk guxonin dhe turpëroheshin me e thënë të vërtetën e me i mbrojt interesat e përgjithshme të qytetarëve gjë për të cilën ishin të thirrur ta bënin. E fillova me rikujtim por po dua t`ua rikujtoj anëtarëve të kuvendit edhe betimin të cilin e kemi dhënë.

Citoj: “Betohe (ose deklaroj solemnisht) se do t’i kryej me nder, me besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t’i ushtroj autorizimet e mia si këshilltar i kuvendit të komunës së Vushtrrisë, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë”.

A e kemi jetësuar këtë betim? Nëse më pyesni mua, unë them jo, por prapë qytetari do t`a vlerësojë. *Të nderuar qytetar të komunës së Vushtrrisë!* Është mirë, madje shumë mirë, që Instituti GAP, Kallxo.com e organizata tjera, merren me hulumtime dhe e njoftojnë opinionin e gjerë për performancën e komunave por jemi në anëtarët e kuvendit që i kemi dëgjuar me vesh e i kemi parë me sy se çfarë u kanë premtuar qytetarëve të Vushtrrisë koalicioni i gjerë qeverisës. Premtimet e paralizuar të koalicionit LDK-LVV 1. Ndërtimi i tregut (Modeli i Tiranës); 2. Largimi i kabllave dhe shtyllave elektrike nga sheshi; 3. Stacioni i autobusëve; 4. Miniera e Dubocit; 5. Fabrika e përpunimit të peshkut; 6. Investim 100 milionë e 620 mijë euro në Çyçavicë të Vushtrrisë; 7. Investim mbi 45 milion euro në Gumnishtë dhe Karaqë; 8. Zgjerim i kanaleve për ujitjen e tokave bujqësore; 9. 5 mijë euro shpërblim për qytetarët që raportojnë rastet e korrupsionit; 10. Hartat zonale. Mos të flasim pastaj për gjendjen e pllakave në bulevardin “Adem Jashari” në qendër të Vushtrrisë, gjendjen e rëndë të trafikut në Vushtrri etj. etj. Të gjithë tashmë e dini se vitin e kaluar kam paralajmëruar mundësinë e mos kandidimit tim në zgjedhjet e radhës. Prandaj unë refuzoj të jem pjesë e kësaj politike, esencialisht primitive dhe skajshmërisht e papërgjegjshme. Kjo politikë e lodhur, zvarritëse në Vushtrri, aq ka degraduar, sa që verbëria e interesave të ngushta e ka mbytur çfarëdo hapësire racionale, ku ikja nga përgjegjësia maskohet me parulla koti partiake. Besoj që ky vendim i imi personal është më i ndershmi edhe ndaj përkrahësve të mi, të cilët i falënderoj nga zemra për përkrahjen e vazhdueshme që ma kanë dhënë dhe nga të cilët kërkoj mirëkuptim. Sido që të jetë ky shqyrtim i angazhimit tim të mëtutjeshëm politik nuk është dorëzim, *unë do të vazhdoj t’i jetësoj bindjet e mia politike edhe jashtë kuvendit.*

Po e përfundoj me një thënie të një aktori amerikan, Uill Roxhers, i cili thoshte:

“Sa më shumë lexoni për politikën, aq më shumë arrini të pranoni se çdo parti është më e keqe se tjetra”.

“Njerëzit që zgjedhin të bëhen gjallesa që shiten e blihen meritojnë vetëm përbuzje.”

Suksese në zgjedhjet e ardhshme më 17 tetor 2021!

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-tha se në vitin 2017 janë zgjedhur këshillat dhe kryetarët e fshatrave dhe këtë vit këtyre ju përfundon mandati. Andaj lidhur me këtë ai pyeti drejtoreshën e Drejtorisë së Administratës, se a ka ndërmarr ndonjë veprim për rizgjedhjen e tyre. Pastaj adresoi shqetësimin e banorëve të Komunës së Vushtrrisë, për mungesat e ujit të pijshëm në këto ditë vape të korrikut dhe për këtë pyeti drejtuesit e Komunës se a janë duke bërë ndonjë veprim.

Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit-adresoj pyetje të parashtruar nga disa qytetar ku shkolla e mesëm Gjinnazi po shfrytëzohet nga disa profesor të shkollës teknike, për ushtrime në basketboll dhe se a është e vërtet që fëmijët paguajnë nga 10 deri 50 euro, ndërsa a janë këta persona të njëjtte që e menaxhojnë klubin e basketbollit “Vushtrria Basket” dhe klubin “Vushtrria”.

Edona Gashi, drejtoreshë e Drejtorisë së Administratës-njoftoi se është rregullorja e cila do të vihet në funksion për këshillat e fshatrave, por ka prej tyre që akoma nuk e kanë përfunduar mandatin deri në muajin gusht, andaj posa të aprovohet kjo rregullore do të fillohet me rizgjedhjen e këshillave të ri.

Arta Ismajli, drejtoreshë e DKRS-së-sqaroi se nuk ka informacionin e duhur se fëmijët paguajnë pagesat e tilla, ndërsa sallat e shkollave në fjalë janë duke u përdorur për aktivitete sportive, pasi që palestra sportive “Jeton Terrsten Tota” është duke u përdorur për vaksinimin e qytetarëve.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-njoftoi se strukturat komunale nuk kanë të drejt dhe nuk përzihen në punët e organeve të drejtësisë, duke ju referuar rastit të shkaktimit të zjarrit njoftoi se dy persona janë arrestuar dhe se organet e drejtësisë janë duke e kryer punën e tyre. Pastaj çështja e rregullimit të rrymës elektrike nuk është në domenin e kompetencave të komunës por të KEDS-it, dhe pikërisht për këtë ai fare nuk është përfshirë në këtë çështje e aq më pak publikisht. Sa i përket rrugës “Hasan Prishtina”, njoftoi se ajo rrugë është duke u rregulluar në saje të donacioneve nga performanca e mirë e komunës, dhe për bëhet verës kur koha është mirë. Sa i përket shënjimit të rrugës në fshati Nedakoc, për tu shfrytëzuar si rrugë alternative, kërkoi që kjo të bëhet menjëherë. Mandej si rrugë alternative për ta shmangur kolonë në rrugën magjistrale, njoftoi se është bërë shenjëzimi nga fshati Gllavatit në drejtim të fshati Bukosh për në Mitrovicë. Rregullimi i urës në fshatin Pestovë është çështje e Ministrisë së Infrastrukturës, dhe për këtë i ka shkruar shkresë zyrtare ministrit gjegjës për takim por që ai nuk ka pranuar, shpronësimi për këtë projekt është bërë nga ana e komunës dhe ky projekt duhet të kryhet nga ane ministrisë. Lidhur me dinamikën e punimeve në rrugën magjistrale, njoftoi se ministria vetëm i ka nxjerr vendimit por akoma nuk janë kryer pagesat nga shpronësimi i pronave të qytetarëve dhe ai i ka lutur ata në mirëbesim që mos ti pengojnë punime në rrugë pasi që pagesat do ti marrin.

Gresa Muli, anëtare e kuvendit-lexoj një kërkesë të një banori të fshatit Oshlan, lidhur me ndërtimin e rrugës Pirç-Oshlan, ti cilën ia adresoj kryetarit Tahir, pas që ky projekt është premtuar të realizohet në projektet e vitit 2018, sepse ka qenë bashkëfinancim me Komunën e Mitrovicës, ku kjo e fundit e ka kryer pjesën e saj ndërsa komuna e Vushtrrisë nuk e ka realizuar pjesën e projektit që është e obliguar.

Basri Menxhiqi, anëtar i kuvendit-ngriti shqetësimin e banorëve të fshatit Bukosh, lagja “Bajgora” lidhur me një fermë të pulave, banorët atje kanë nënshkruar për ta kundërshtuar këtë projekt, sepse afër shtëpive të banimit është ngritur kjo fermë dhe kundërmon erë tepër të keqe, kërkojnë nga organet komunale që të ndermirren veprime për parandalimin këtij projekti.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-tha se në bashkëpunim me komunën e Mitrovicës, do të ndërtohet rruga Pirç-Oshlan, ose Komuna e Mitrovicë do ta përfundoj këtë projekt, ndërsa komuna jonë do ti transferoj mjetet financiare për këtë projekt.

Në fund të debatit për rendin e ditës, Kuvendit i Komunës së Vushtrrisë me 32 vota “për” 1 votë e përmbajtur aprovoi këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, mbajtur më 24 qershor 2021;
2. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për periudhën janar-qershor 2021;
3. Shqyrtimi i raportit tremujor mbi të hyrat dhe shpenzimet buxhetore;
4. Shqyrtimi i Informatës tremujore për sigurinë e produkteve ushqimore;
5. Shqyrtimi i Informatës lidhur me zbatimin e vendimeve të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për periudhën janar-qershor 2021;
6. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për ofrimin e përkrahjes financiare për Klubin e Futbollit “Vushtrria”;
7. Shqyrtimi i kërkesës nga Këshilli i Bashkësisë Islame në Vushtri lidhur me ndërtimin e Xhamisë në Qytetin e Vushtrrisë;
8. Shqyrtimi i Draft- Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2020-2025;
9. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për dhënien e Titullit “Qytetar Nderi” për z. Ramiz Tafilaj;
10. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, mbajtur më 24 qershor 2021;

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-kërkoj që në procesverbal të përmirësohet diskutimi sa i përket fjalës: që në rrugën magjistrale, në perimetër prej 150 metra në lartësi të rrugës, po lejohet ndërtimi, ndërsa nuk po lëshohet certifikata e legalizimit nuk po lejohet legalizimi.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me votim “unanim” aprovoi procesverbalin nga mbledhja e rregullt e kuvendit, e datës 24 qershor 2021, me vërejtjen e paraqitur më lartë.

2. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për periudhën janar-qershor 2021;

Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit-tha se në informatë është e evidentuar, se në gjashtë mujorin e parë të vitit 2021 se janë 549 raste prej të cilave 358 të kualifikuar si vepra penale, ndërsa 162 raste janë kualifikuar se kundërvajtje dhe raste të natyrave tjera, krahasuar me vitin 2020 numri i rasteve ka shënuar ngritje të lehtë prej 90 rasteve. Kjo nuk duket e arsyeshme të cilësohet si ngritje e lehtë sepse nuk është numër i vogël 90 raste ose rritej prej 19.6 %.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-tha se është shqetësues fakti se në këtë informatë, nuk është shkruar asnjë paragraf lidhur me qenët endacak, edhe pse ata paraqesin një problem të madh për

sigurinë e qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë. Pastaj në informatë nuk evidentohet se Stacioni Policor i Vushtrrisë a është marrë me peronat narkoman pasi që kemi një trend negativ të këtij fenomeni në shoqërinë tonë dhe për këtë problematikë nuk është thënë asnjë fjali.

Reshat Kovaçi, komandat i stacionit Policorë në Vushtrri-në adresimin e tij para anëtarëve të kuvendit vlerësoi se konsiderohet se kemi rritej të lehtë të rasteve të kriminalitetit apo të veprave penale, në gjatë mujorin e vitit 2021 për faktin se viti 2020 është karakterizuar me pandeminë covid-19 , dhe me mbyllje të ekonomisë dhe vendit dhe kjo rrjedhimisht ka ndikuar në uljen e numrit të veprave penale. Rritja kryesisht ka konsistuar në aksidentet e trafikut, dhe të veprat penale vjedhje e rëndë dhe kjo ka ndodhur sepse pas pandemisë dhe hapjes së qytetit janë rritur aktivitetet e qytetarëve dhe rrjedhimisht ka ndodhur rritja e numrit të veprave penale. Pastaj tek trajtimi i qeneve endacak, përgjegjësia e tyre është e vogël, sepse policia ofron siguri për qytetarët, por nuk mund ta rregulloj problemin me qenët endacak dhe se kjo temë bie në kompetencë të komunës e jo të policisë. Lidhur me personat narkoman, në policinë e Kosovës ka njësi që merren me specifikat e krimit e që në këtë rast përgjegjësia e stacionit policorë nuk qëndron për të qenë plotësisht kompetent në trajtimin e këtyre rasteve. Aksenti i veprimeve të tyre për këtë problematikë është në planin operativ në preventiven e fenomenit të narkomanisë, por gjithëherë në bashkëpunim me njësitë rajonale të Drejtorisë Rajonale të Policisë në Mitrovicë.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-kërkoi nga komandanti i stacionit policor, që në këtë material herëve tjera të shënoj emërtimin si informatë, pasi që po keqkuptohet fakti se policia nuk i raporton kuvendit por vetëm e informon atë.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-pasi falënderoi policinë e Kosovës për bashkëpunimin e mirë që kanë pas me Komunën e Vushtrris në menaxhimin e pandemisë si një sfidë tepër e rënd, apeloj që të përmbahemi nga komentet me qëllime politike, për shkak se informata e policisë nuk ndryshon në kuvend. Kjo pasi që kuvendi vetëm informohet nga ana e policisë së Kosovës, dhe nëse policia vlerëson se është ngritje e lehtë e veprave penale është vlerësim i policisë e jo i kuvendit. Kjo është kështu dhe se nuk ju takon përfaqësuesve politik që të kërkojnë ndryshimin e informatës. Vlerësimet se ka rritej të lehtë janë të qëndrueshme, sepse vitin që lëmë pas ishte viti kur ishte e mbyllur gjithçka sidomos periudha e parë e vitit, dhe normalisht nuk kishte aktivitet dhe rrjedhshëm ka pasur më pak aksidentet të trafikut.

3. Shqyrtimi i raportit tremujor mbi të hyrat dhe shpenzimet buxhetore;

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës kuvendi pas votimit me 22 vota “për” 1 votë “kundër” 1 votë “abstenim” aprovoj raportin tremujor mbi të hyrat dhe shpenzimet buxhetore.

4. Shqyrtimi i Informatës tremujore për sigurinë e produkteve ushqimore;

5. Shqyrtimi i Informatës lidhur me zbatimin e vendimeve të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për periudhën janar-qershor 2021;

6. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për ofrimin e përkrahjes financiare për Klubin e Futbollit “Vushtrria”;

Arta Ismajli, drejtoreshë e DKRS-së-tha është tepër e nevojshme të merret sot ky vendim, për ta subvencionuar klubin e futbollit “Vushtrria”, pasi që klubi gjendet në një krizë të thellë

financiare, dhe kjo është reflektuar edhe në aktivitetin dhe rezultate e tij. Lidhur me statusin juridik të këtij klubi ajo argumentoj se ai klub është OJQ dhe kjo mund të verifikohet nga kushdo qoftë që dëshiron të dijë. Pastaj e drejta e Drejtorisë për Sport është vetëm vëzhguese dhe se në cilësinë e vëzhguese në kuvendi zgjedhor të klubit ka preferuar që ajo të jetë e pranishme personalisht. Andaj nga prania e saj në atë mbledhje, kuvend-zgjedhor ka pasur çështje teknike, dhe gjithçka ka shkuar sipas rregullit dhe kjo është konstatuar edhe në raportin që e ka lëshuar Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport. Nuk ka pasur asnjë lloj presioni që është pretenduar prej dikujt dhe se të gjithë anëtarët e kuvendit kanë qenë të lirë në të drejtën e votimit ashtu siç ata kanë menduar dhe vlerësuar. Kryesia që është zgjedhur ku bën pjesë edhe një drejtor i qeverisë aktuale komunale, nuk i takon që ajo ta komentoj, ndërsa raporti nga ai takim është dorëzuar në të gjitha instancat e duhura ligjore. Për sa i takon menaxhimin të stadiumit të futbollit ajo deklaroi se i janë dashur vetëm 3 orë që ai të kthehet nënë menaxhimin e komunës dhe i vjen keq që kjo çështje nuk është zgjidhur më herët. Lidhur me propozim-vendimin për subvencionim të klubit të futbollit i cili është sponsorizuar nga kryetari i komunës dhe Drejtoria e Kulturës, njoftoi se ajo ka marr një opinion me shkrim nga zyra ligjore e komunës, që është hartuar më herët për raste e tilla të subvencionimit, por që sipas saj në këtë opinion nuk janë dhënë shpjegimet e duhura sipas përcaktimeve dhe zgjedhjeve që i jep ligji. Kjo për faktin se deri në vlerën 500 € subvencion ka të drejtë ti ndaj Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ndërsa kryetari i komunës ka të drejtë deri në 1000 € subvencion ti lejoj me vendim të tij. Por shumë prej 45,000.00 € kanë vendosur që ti procedojnë kuvendit për ti aprovuar, pasi që shumica e komunave kanë vepruar kështu duke e anashkaluar rregulloren me një votim paraprak dhe më vonë aprovimin e shumës së propozuar financiare nga ana e kuvendit, kështu është vepruar në shumë komuna dhe nuk është se kemi pasur vlerësime negative nga ministria e linjës. Në fund ajo kërkoi nga anëtarët e kuvendit që ta mbështesin me votë unanime propozim-vendimin në fjalë.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-tha se është drejtoresha që ishte në detyrë më herët e cila kishte deklaruar se klubi ishte privatizuar dhe deklarime të tilla kishte pasur edhe nga kryetari i komunës për një gjë të tillë, në atë kohë i vetmi kishte qenë që kishte reaguar se një formë e tillë e privatizimit ishte e kundërligjshme. Pastaj shtoi se po të ekzistonte klubi si QJQ peroni që pretendon se e ka privatizuar klubin nuk do të mund të merrte numër fiskal, andaj nuk duhet të thjeshtëzohen së tepërmi gjërat sepse akoma nuk kemi një shpjegim të qartë lidhur me statusin e klubit. Andaj nga kjo bëri thirrje që mos të kemi devijim të deklarimeve në sytë e opinionit publik, sepse krahasimi për dashuri ndaj futbollit se kush e donë futbollin më shumë është i padrejtë dhe krahasimi tjetër me Gjilanin është i pavend sepse ata kanë dy klube që janë në ligën e parë respektivisht në super ligë, ndërsa ne si klub jemi në ligën e dytë, kjo i bie se ata kanë të dejtë morale që të ndajnë mjetet financiare për klubin e tyre. Në fund tha se është mirë që të dihet se a është privatizuar ky klub sepse ka pasur deklarime, ndërsa pyeti se a ka reagime dhe ankesa për këtë çështje.

Bahrije Ademi Murati, anëtare e kuvendit-tha se edhe kësaj radhe si shumë tjera zyra e kryetari dhe ekzekutivi, po i sjellin anëtarët e kuvendit në situata të pa lakmueshme, sepse në saje të asaj që u tha pretendohet që mbi asnjë bazë ligjore të ngitet dora për votimin e shumës prej 45,000.00 € dhe se në anë tjetër kjo është sikur thikë me dy tehe, sepse të gjithë ne po shprehemi se nuk jemi kundër futbollit dhe sportit në përgjithësi e aq më pak duke e ditur gjendjen në klubin e futbollit, por ti ndajmë një shumë kaq të madhe të mjeteve financiare pa asnjë bazë ligjore është vërtet e paarsyeshme.

Adnan Lahu, drejtor i DGJKP-së-tha se nëse dikujt i pengon emri i tij në kryesin e klubit është mirë që atë ta thotë publikisht, sepse përse i pengon, pasi nuk është ai i pari që dikush nga politika merret dhe futet në strukturat e sportit përkatësisht klubit të futbollit. Sa i përket subvencionimit,

vlerësoi se kuvendi ka të drejtë të subvencionoj një OJQ, por assesi nuk ka të drejtë të subvencionoj një biznese privat. Ai njoftoi dhe deklaroi se ka pasur përpjekje dhe ato janë të faktume publikisht për privatizimin e klubit por se ato nuk janë konkretizuar deri në fund. Ai zotohet se klubi do të kthehet edhe më shpejt në formë se sa të tjerët mendojnë. Pastaj mendon se të gjithë e duan klubin porse nuk është mirë që të bëhet politikë me këtë klub e as me sportin në përgjithësi.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-tha se gjendje e klubit është jashtëzakonisht e keqe, sepse ka rezultate shumë të dobëta duke rënë në ligën e dytë. Dhe shtoi duke replikuar se ai përmend emra për faktin se kur e shikon Drejtorinë e Kadastrit, si anëtarë të kryesitë së klubit të futbollit sheh konflikt interesi i cili nuk është dashur të jetë fare sot në këtë seancë të kuvendit. Tutje shtoi se nëse dikush është në kryesin e një klubi nuk do të thotë se donë futbollin më shumë se sa dikush tjetër. Ai shprehu shqetësimin për rezultatet e klubit dhe këto rezultate kaq të ulëta kanë ndodhur në kohën e qeverisjes LDK-LVV, por për këtë kërkoj përpjekje të përgjithshme për ngritjen e tij.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-tha se votimi për shmangie të rregullores duhet të bëhet për faktin se rregullorja për subvencione përcakton se ndarja e shumave financiare subvencioneve mbi shumën prej 1000 € duhet të bëhet përmes thirrjes publike, por meqë gjendja në klubin e futbollit është e rënduar dhe me qëllim që të ndihmohet ky klub duhet të shmanget kjo rregullore për ta marrë këtë vendim.

Në fund të debati lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendi pas votimit me 15 vota “për” asnjë “kundër” asnjë “abstenim” të tjerët nuk morën pjesë në votim u vendos më sa vijon:

1. Me këtë vendim ofrohet përkrahje financiare në shumë prej dyzetepesëmijë euro (45,000.00 €) për Klubin e Futbollit “Vushtrria” në Vushtri.
2. Mjetet financiare të cekur si në pikën paraprake të këtij vendim do të sigurohen nga buxheti i komunës – kategoria subvencione dhe transfere, në njësitë buxhetore në të cilat ka mjete të lira.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport.
4. Vendimi hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Pas votimit të kësaj pike të rendit të ditës, kryesuesi i kuvendit konstatoj se në sallë e mbledhjes janë prezentë 28 anëtarë të kuvendit, 15 prej tyre votuan “për” asnjë “kundër” asnjë “abstenim” të tjerët nuk morën pjesë në votim, andaj për ti zgjedhur dilemat procedurale, lidhur me plotfuqishmërinë e këtij vendimi, konstaton se do ta marr mendimin profesional nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe nga Zyra Ligjore e Komunës.

7. Shqyrtimi i kërkesës nga Këshilli i Bashkësisë Islame në Vushtri lidhur me ndërtimin e Xhamisë në Qytetin e Vushtrrisë;

Adnan Lahu, drejtor i DGJKP-së-njoftoi kuvendit se në vitin 2019 AKP-ja, ka marr një vendim për Komunën e Vushtrrisë që në disa prona që evidentohen në emër të AKP-së, komuna të ketë të drejtën e investimeve në zhvillimin e projekteve në interes të përgjithshëm. Andaj kërkesa e KBI-së në Vushtri konsiston në aprovimin e një rekomandimi për Drejtorinë e Urbanizmit për sa i

takon pajisje me leje ndërtimore për ndërtimin e Xhamisë. Më tej sqaroi se për shkak të aspekteve teknike të AKP-së prona e që evidentohet në emër të kësaj të fundit nuk ka mundur të bartet në emër të komunës, por që zhvillimi i projekteve në pronë e AKP-së është lejuar në saje të pëlqimit që ka dhënë vetë AKP-ja, respektivisht Qeveria e Kosovës.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-tha se dallon situata nga vendimi për dhënien e pronës në shfrytëzim, sepse në rastin konkret kemi të bëjmë me një kërkesë nga Këshilli i Bashkësisë Islame në Vushtrri për të ndërtuar një Xhami, në pronën e AKP-së, e që kjo e fundit ka dhënë pëlqimin për zhvillimin e projekteve për interes publik në pronë që evidentohet në emër të saj. Ajo çka është e rëndësishme është që dihet që ajo pronë a është e evidentuar në planë dhe në hartat zonale të komunës.

Berat Sadiku, drejtor i DUMM-së-tha se kërkesa e Këshillit të Bashkësisë Islame në Vushtrri, konsiston në marrjen e një rekomandimi nga kuvendi, ashtu që ti lehtësohet rruga për thithur ndonjë donacion nga jashtë për ndërtimin e Xhamisë. Drejtoria e Urbanizmi do ta pajisë me leje ndërtimore KBI-në në Vushtrri për ndërtimin e Xhamisë, konform Planit Zhvillimor Komunal dhe në bazë të Hartës Zonale të Komunë e cila do të hy në fuqi pas aprovimit në kuvend. Në rastin konkret është mirë që kuvendi ti lëshoj një rekomandim DUMM-së, për ta pajisur me leje ndërtimore KBI-në, pasi që prona e apostrofuat është zonë ndërtimore në saje të PZHK-së.

Në fund të debati lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më datë 29 korrik 2021, pas shqyrtimit të kërkesës të Këshillit të Bashkësisë Islame në Vushtrri, lidhur me pajisjen me leje ndërtimore për ndërtimin e Xhamisë në parcelën kadastrale P-70202016-02253-5, pas debateve dhe analizës së hollësishme të lartë shënuarit i parashtron këtë:

REKOMANDIM

I Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë i rekomandon Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, që ti ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme procedurale dhe ligjore për pajisjen me leje ndërtimore Këshillin e Bashkësisë Islame, sa i përket ndërtimit të Xhamisë në pronën e cekur si më lartë.

II Obligohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, që më rastin e pajisjes me këtë leje ndërtimore të respektoj legjislacionin në fuqi që lidhet me domenin e zhvillimit lokal të planifikimit urban, ruajtjen e mjedisit si dhe duke u bazuar në dokumentet e planifikimit urbane siç është Plani Zhvillimor Komunal dhe Hartat Zonale.

8. Shqyrtimi i Draft- Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2020-2025;

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës kuvendit pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim aprovohet Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal e Komunës së Vushtrrisë 2020-2025.

2. Qëllimi i aprovimit të kësaj strategjie është konsolidimi i infrastrukturës juridike në aspektin e përmirësimit të strukturës ekonomike, rritjen e punësimit, avancimin e, prodhimitarisë, bujqësisë moderne dhe turizmit si dhe krijimin e një ambienti për përshpejtimin e zhvillimit të përgjithshëm ekonomik lokal të Komunës së Vushtrrisë.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: kryetari i komunës, Drejtorja për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural si dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.

4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është dokumenti me emërtimin Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal e Komunës së Vushtrrisë.

5. Ky vendim hyn në fuqi 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

9. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për dhënien e Titullit “Qytetar Nderi” për z. Ramiz Tafilaj;

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-arsyetoj para kuvendit se z. Ramiz Tafilaj, është i lindur në Deçan jeton dhe vepron në SHBA, është biznesmen i shquar dhe peroni i njohur në lobin shqiptarë në botë. Tutje shtoi se Ramiz Tafilaj është një biznesmen, filantrop, aktivist dhe botues shqiptaro-amerikan. Ai u shkollua në Universitetin e Zagrebit para se të emigronte në Shtetet e Bashkuara në vitin 1974 dhe vazhdoi arsimin e tij të lartë në Hjuston. Pasi filloi karrierën e tij si një programues kompjuterësh, Tafilaj u bë një sipërmarrës i suksesshëm në industrinë e teknologjisë së lartë dhe petrokimike. Ai themeloi Superior Computer Services dhe Progressive Chemical Technology, ku shërben si kryetar i bordit, dhe gjithashtu zotëron Kompaninë Botuese Jalifat. Tafilaj shërbeu si President i Divizionit Ndërkombëtar të Dhomës së Tregtisë Veriperëndimore ku ai promovoi bizneset e Teksasit ndërkombëtarisht, përmes delegacioneve në vendet në të gjithë Evropën dhe Azinë. Ai është Nënkryetar i Shoqatës së Biznesit Shqiptaro Amerikan të Teksasit të Madh. Tafilaj është një vizionar për lirinë dhe demokracinë në Shqipëri dhe Kosovë dhe publikoi serinë e suksesshme të librave Kosova, historia e parë e këtij lloji gjithëpërfshirëse e Kosovës. Një avokat i vendosur për arsimin, Tafilaj sponsorizoi më shumë se 100 studentë nga e gjithë bota në ndjekjen e tyre të të mësuarit, duke përfshirë studentë nga Kosova, Rusia, Turqia, Egjipti, Evropa dhe Lindja e Mesme. Në vitin 2018, Tafilaj u nderua me Çmimin e Presidentit për Arritjet e Jetës (President's Lifetime Achievement Award), shpërblimi më i lartë për civilët që modelojnë shpirtin Amerikan. Në vitin 2019, në vendlindjen e tij në Deçan, ai mori njohje nga kolegët e tij për kontributet e tij në promovimin e demokracisë përmes punës së tij në botim. Dhe në vitin 2020 Tafilaj mori Certifikatën e Lirisë Idriz Seferi për kontributin e tij në edukimin e të rinjve të komunitetit në Gjilan. Tafilaj është i martuar me, Dianën, për 47 vjet dhe ata kanë tre fëmijë të rritur. Është një sipërmarrës, një VP në industrinë bankare dhe një ekzekutiv jofitimprurës. z. Tafilaj dhe ka nëntë nipër dhe mbesa.

Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit-tha se është mirë që kryetari i komunës e arsyetoj mirë propozimin duke i kompletuar informatat dhe ai personalisht është pro që të nderohet figura e z.Ramiz Tafilajt.

Në fund të debati lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendi pas votimit me 19 vota “për” të tjerët nuk morën pjesë në votim, vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim z. Ramiz Tafilaj, veprimtar i shquar Shqiptaro Amerikan, me prejardhje nga Kosova, i jepet titulli “Qytetar Nderi” i Vushtrrisë.

2. Dorëzimi i këtij titulli z. Tafilaj i bëhet nga Kryetari i Komunës në mbledhjen solemne të Kuvendit të Komunës.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

4. Vendimi hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Mbledhja përfundoi në ora 12:48.

Bastri Duraku

Nasuf Aliu

Procesmbajtës

Kryesues i Kuvendit



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA VUSHTRRI

Datë 17.09.2021

Për: Kuvendin e Komunës

Propozues: Xhafer Tahiri, Kryetari i Komunës

Hartues: ZKF, Abit Abiti

Propozim - Vendim: Për aprovimin e Buxhetit të Komunës së Vushtrrisë

Në bazë të nenit 12, paragrafi 1, pika "d" në lidhje me nenin 24, paragrafi 2, nenit 40, paragrafi 2, pika "b" të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 40.2 "b" dhe 41, paragrafi 2, pika "ç" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, si dhe në bazë të propozimit të Kryetarit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më _____ shtator 2021, mori këtë:

V E N D I M

PËR APROVIMIN E BUXHETIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË PËR VITIN 2022 SI DHE PROJEKSIONET PËR VITIN 2023 DHE 2024

1. Me këtë vendim aprohet buxheti i Komunës së Vushtrrisë, dhe lista e projekteve kapitale për vitet 2021-2023, konform Qarkoreve Buxhetore 01/2021 dhe 03/2021 të lëshuara nga MF-ja.

2. Shuma e përgjithshme e buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2021 është **19,862,886.00 €** prej të cilave për:

2.1 Paga dhe mëditje.....	10,720,000.00 €
2.2 Mallra dhe shërbime.....	3,278,239.00 €
2.3 Shpenzime komunale.....	428,000.00 €
2.4 Subvencione.....	657,540.00 €
2.5 Shpenzime kapitale.....	4,779,107.00 €

Gjithsej:..... 19,862,886.00 €.

3. Të hyrat vetanake të planifikuara.....2,262,795.00 €.

4. Mjetet financiare të cekura në pikën 2 dhe 3 të këtij vendimi janë në pajtim me Qarkoret Buxhetore 01/2022 dhe 02/2022 të MFPT-së, si dhe në bazë të kufijve buxhetorë.

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Kryetari i komunës dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.

6. Tabela 4.1- plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të komunës për vitin 2022-2024; tabela 4.2 – investimet kapitale në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2022-2024; tabela 4.3 - të hyrat vetanake të komunës për vitet 2022-2024, si dhe tabelat e buxhetimit të përgjithshëm gjinor janë pjesë e këtij vendimi, të bashkëngjitura në shtojcë.

7. Ky vendim hyn në fuqi pas aprovimit dhe nënshkrimit nga kryesuesi i kuvendit dhe i njëjti i dorëzohet Ministrisë së Financave për zbatim.

Nasuf Aliu

Kryesues i Kuvendit

Arsyetim

Duke u bazuar në qarkoret buxhetore si dhe standardet dhe instruksionet e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve , Drejtoria për Buxhet dhe Financa, ka përgatitur draft-buxhetin e Komunës së Vushtrrisë për vitet 2022-2024, duke i përfillur hapat dhe legjislacionin në fuqi që i referohen financave publike.

Drejtoria ka realizuar dëgjimet buxhetore konform kushteve të krijuara nga pandemia Covid-19, duke adresuar nevojat dhe kërkesat e qytetarëve.

Nga të cekura më lartë i propozojmë Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë që ta aprovoj propozim-vendimin si në dispozitiv.



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA VUSHTRRI

DATË/A:	14.09.2021
PËR/ZA/TO:	KPF dhe Kuvendin e Komunës
NGA/OD/FROM:	Xhafer Tahiri, Kryetar i Komunës Abit Abiti, ZKF
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Peropozim buxheti për vitin 2022-20224

Procesi buxhetor 2022-2024 ka për qëllim ndërlidhjen e planeve dhe politikave buxhetore të Qeverisë me nevojat ekonomike dhe sociale të Komunës

Gjatë procesit buxhetor së pari i kemi kushtuar kujdes obligimeve kontraktuese dhe nevojave të qytetarëve .

Parimet e planifikimit buxhetor për vitin 2022 janë;

1. Burimet e financimit
2. Kategoritë ekonomike
3. Ndarjet buxhetore

Burimet e financimit.- Buxheti i planifikuar për vitin 2022 është 19,862,886.00 € ky buxhet financohet nga grantet qeveritare në shumë 17,600,091.00€ ose 89% si dhe nga të hyrat vetanake në shumë 2,262,795.00€ ose 11%

Kategoritë ekonomike.- Me Kornizën Afatmesme Komunale shuma e planifikuar për paga dhe mëditje është 10,720,000.00 ose 54% e shumës së tërësishme . Këtë shumë e kemi planifikuar bazuar në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve të nivelit Qendror me të cilin dokument parashihet një rritje rreth 2%.

Kategoria Mallra dhe shërbime financohet në lartësi prej 3,278,239.00 € ose 16.5%

Shuma e ndarë për Subvencione dhe transfere për vitin 2020 është 657,540.00 €. Në këtë kategori kemi pasur një rritje të konsiderueshme vitin e kaluar, kurse këtë vit kemi një rritje të lehtë, rreth 57,000.00 €

Te kategoria e shpenzimeve komunale gjithashtu kemi një shumë ndarë më të lartë për fakti se janë shtuar vijate ndriçimit publik dhe është ndryshuar mënyra e ngrohjes në Arsimin e mesëm

Shpenzimet Kapitale për vitin 2020 janë 4,779,107.00€. Këto shpenzime paraqesin pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve dhe marrin pjesë me 25% në shpenzimet e tërësishme.

Tabela 4.1 Plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të komunës për vitin 2022-2024

Kod.	Kod.i programi t/nenprog ramit	Përshkrimi	Stafi 2022	Pagat dhe mëdirjtet	Malltrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencionet dhe transferet	Shpenzimet kapitale	Total
		Ndryshimi		-					
644		TOTAL SHPENZIMI	1,601	10,720,000.00	3,278,239.00	428,000.00	657,540.00	4,779,107.00	19,862,886.00
		Grantet Qeveritare		10,690,000.00	2,214,299.00	378,000.00	548,828.00	3,768,964.00	17,600,091.00
		Të hyrat vetanake		30,000.00	1,063,940.00	50,000.00	108,712.00	1,010,143.00	2,262,795.00
		Huamarrja							-
16024		Zyra e Kryetarit	25	203,850.00	71,632.00		40,000.00		315,482.00
		Grantet Qeveritare		203,850.00	51,632.00		40,000.00		295,482.00
		Të hyrat vetanake			20,000.00				20,000.00
16924		Zyra e Kuvendit Komunal		135,535.00	5,216.00				140,751.00
		Grantet Qeveritare		135,535.00					135,535.00
		Të hyrat vetanake			5,216.00				5,216.00
1.3	163	Administrata dhe personeli	30	193,271.00	177,867.00			60,000.00	431,138.00
		Grantet Qeveritare		193,271.00	136,367.00			48,000.00	377,638.00
		Të hyrat vetanake			41,500.00			12,000.00	53,500.00
1.3.1	16324	Administrata	28	180,080.00	174,567.00			60,000.00	414,647.00
		Grantet Qeveritare		180,080.00	134,567.00			48,000.00	362,647.00
		Të hyrat vetanake			40,000.00			12,000.00	52,000.00
1.3.6	16524	Çështjet gjinore	2	13,191.00	3,300.00				16,491.00
		Grantet Qeveritare		13,191.00	1,800.00				14,991.00
		Të hyrat vetanake			1,500.00				1,500.00
16647		Inspektimet	15.00	102,205.00	25,900.00				128,105.00
		Grantet Qeveritare		102,205.00	10,900.00				113,105.00
		Të hyrat vetanake			15,000.00				15,000.00
16820		Prokurimi	6.00	46,984.00	4,050.00				51,034.00
		Grantet Qeveritare		46,984.00	1,000.00				47,984.00
		Të hyrat vetanake			3,050.00				3,050.00
17524		Buxhetimi	27	162,812.00	28,207.00				191,019.00
		Grantet Qeveritare		162,812.00	20,887.00				183,699.00

1.7	180	Të hyrat vetanake	48	310,612.00	7,320.00	235,000.00	-	1,300,000.00	7,320.00
		Shërbimet publike, mbrojtja			1,010,528.00	235,000.00	-	1,300,000.00	2,856,140.00
		Grantet Qeveritare		310,612.00	301,349.00	205,000.00	-	925,000.00	1,741,961.00
		Të hyrat vetanake		-	709,179.00	30,000.00	-	375,000.00	1,114,179.00
1.7.1	18184	Infrastruktura Publike	13	76,941.00	913,728.00	235,000.00	-	1,300,000.00	2,525,669.00
		Grantet Qeveritare		76,941.00	238,449.00	205,000.00	-	925,000.00	1,445,390.00
		Të hyrat vetanake		-	675,279.00	30,000.00	-	375,000.00	1,080,279.00
1.7.6	18428	Zjarrfiksat dhe inspektimet	31	205,896.00	50,600.00	-	-	-	256,496.00
		Grantet Qeveritare		205,896.00	37,700.00	-	-	-	243,596.00
		Të hyrat vetanake		-	12,900.00	-	-	-	12,900.00
1.7.7	18468	Menaxhimi I Katastrofave Nat	4	27,775.00	46,200.00	-	-	-	73,975.00
		Grantet Qeveritare		27,775.00	25,200.00	-	-	-	52,975.00
		Të hyrat vetanake		-	21,000.00	-	-	-	21,000.00
19620		Zyra komunale për komunitete	9.00	47,045.00	8,000.00	15,000.00	5,000.00	-	75,045.00
		Grantet Qeveritare		47,045.00	4,000.00	15,000.00	5,000.00	-	71,045.00
		Të hyrat vetanake		-	4,000.00	-	-	-	4,000.00
47024		Bujqësia	15	94,450.00	39,000.00	-	200,000.00	288,000.00	621,450.00
		Grantet Qeveritare		94,450.00	20,000.00	-	170,000.00	220,000.00	504,450.00
		Të hyrat vetanake		-	19,000.00	-	30,000.00	68,000.00	117,000.00
65120		Shërbimet kadastrale	14	87,601.00	5,500.00	-	-	-	93,101.00
		Grantet Qeveritare		87,601.00	2,500.00	-	-	-	90,101.00
		Të hyrat vetanake		-	3,000.00	-	-	-	3,000.00
66425		Planifikimi urban dhe inspeksio	9	61,344.00	43,250.00	-	-	1,970,607.00	2,075,201.00
		Grantet Qeveritare		61,344.00	30,000.00	-	-	1,583,464.00	1,674,808.00
		Të hyrat vetanake		-	13,250.00	-	-	387,143.00	400,393.00
1.15	730	Shëndetësia dhe mirëqenia	234	1,912,449.00	594,044.00	58,000.00	262,540.00	193,000.00	3,020,033.00
		Grantet Qeveritare		1,902,449.00	540,419.00	58,000.00	242,540.00	193,000.00	2,936,408.00
		Të hyrat vetanake		10,000.00	53,625.00	-	20,000.00	-	83,625.00
		Huamarrja		-	-	-	-	-	-
1.15.1	73033	Administrata	5	36,854.00	2,625.00	-	207,540.00	-	247,019.00
		Grantet Qeveritare		36,854.00	1,000.00	-	187,540.00	-	225,394.00
		Të hyrat vetanake		-	1,625.00	-	20,000.00	-	21,625.00
1.15.2	74450	SH.K.P.SH	205	1,706,000.00	481,419.00	45,000.00	55,000.00	188,000.00	2,475,419.00
		Grantet Qeveritare		1,696,000.00	441,419.00	45,000.00	55,000.00	188,000.00	2,425,419.00
		Të hyrat vetanake		10,000.00	40,000.00	-	-	-	50,000.00
		Huamarrja		-	-	-	-	-	-

1.15.4	75616	Shërbimet Sociale	13	80,345.00	35,000.00	5,000.00	-	-	120,345.00
		Grantet Qeveritare		80,345.00	23,000.00	5,000.00	-	-	108,345.00
		Të hyrat vetanake			12,000.00				
1.15.4	75617	Shërbimet Rezidenciale	11	89,250.00	75,000.00	8,000.00	-	5,000.00	177,250.00
		Grantet Qeveritare		89,250.00	75,000.00	8,000.00		5,000.00	177,250.00
		Të hyrat vetanake							
	85024	Shërbimet kulturore	35	191,242.00	44,600.00	-	90,000.00	413,500.00	739,342.00
		Grantet Qeveritare		191,242.00	31,800.00		50,000.00	315,500.00	588,542.00
		Të hyrat vetanake			12,800.00		40,000.00	98,000.00	150,800.00
1.18	920	Arsimi dhe shkenca	1,134	7,170,600.00	1,220,445.00	120,000.00	60,000.00	554,000.00	9,125,045.00
		Grantet Qeveritare		7,150,600.00	1,063,445.00	100,000.00	41,288.00	484,000.00	8,839,333.00
		Të hyrat vetanake		20,000.00	157,000.00	20,000.00	18,712.00	70,000.00	285,712.00
1.18.1	92120	Administrata	12	84,600.00	691,411.00	120,000.00	60,000.00	190,000.00	1,146,011.00
		Grantet Qeveritare		84,600.00	591,411.00	100,000.00	41,288.00	140,000.00	957,299.00
		Të hyrat vetanake			100,000.00	20,000.00	18,712.00	50,000.00	188,712.00
1.18.2	92670	Arsimi Parashkollor dhe qerdh	42	222,300.00	68,000.00	-	-	25,000.00	315,300.00
		Grantet Qeveritare		222,300.00	23,000.00			5,000.00	250,300.00
		Të hyrat vetanake			45,000.00			20,000.00	65,000.00
1.18.3	93690	Arsimi Fillor	858	5,258,700.00	321,379.00	-	-	275,000.00	5,855,079.00
		Grantet Qeveritare		5,258,700.00	321,379.00			275,000.00	5,855,079.00
		Të hyrat vetanake						-	-
		Huamarjja							-
1.18.4	94890	Arsimi i mesëm	222	1,605,000.00	139,655.00	-	-	64,000.00	1,808,655.00
		Grantet Qeveritare		1,585,000.00	127,655.00			64,000.00	1,776,655.00
		Të hyrat vetanake		20,000.00	12,000.00				32,000.00

275,000.00	-	275,000.00	376,000.00	396,000.00	1,047,000.00
------------	---	------------	------------	------------	--------------

	Komuna: Vushtrri	THV - 2022	THV - 2023	THV - 2024
1	Buxhet dhe Financa	1,038,124.00	1,087,943.00	1,162,163.00
1.1.	Taksat e firmave	10,000.00	8,000.00	5,000.00
1.2.	Tatimi në pronë	840,000.00	854,194.00	886,265.00
1.3	Tatimi në toka	188,124.00	225,749.00	270,898.00
2	Inspektimet	12,000.00	15,000.00	15,000.00
2.1	Pranime teknike	5,000.00	6,000.00	6,000.00
2.2	Pëlqime sanitare	6,000.00	8,000.00	8,000.00
2.3	Gjobat e inspektionit	1,000.00	1,000.00	1,000.00
3	Administrata	70,000.00	80,000.00	80,000.00
3.1.	Shërbimet administrative	70,000.00	80,000.00	80,000.00
4	Urbanizmi	240,892.00	213,145.00	243,413.00
4.1.	Lejet për ndërtim dhe konstruktive	235,892.00	163,145.00	193,413.00
4.2	Shfrytëzimi i pronës publike	5,000.00	50,000.00	50,000.00
5	Gjeodezi dhe kadastër	73,000.00	73,000.00	75,000.00
5.1.	Hipoteka, RDDP, dalje në terren	50,000.00	45,000.00	45,000.00
5.2.	Qiraja e pronave publike	23,000.00	28,000.00	30,000.00
6	Ekonomi dhe bujqësi	10,000.00	20,000.00	10,000.00
6.1	Ndërrimi i tokës bujqësore në ndërtimore	10,000.00	20,000.00	10,000.00
7	Kulturë, rini, sport	2,500.00	2,000.00	2,000.00
7.1.	Palestra sportive	1,000.00	1,000.00	1,000.00
7.2.	Bibliotekat	500	500	500
7.3.	Shtëpia e kulturës	1,000.00	500	500
8	Shërbimet publike	690,279.00	758,000.00	764,146.00
8.1	Ndalja e veturave në rrugë	2,000.00	3,000.00	4,000.00
8.2	Taksat rrugore	83,000.00	90,000.00	91,052.00
8.3	Taksa për mbeturina	605,279.00	665,000.00	669,094.00
I	Totali i Administratës komunale	2,136,795.00	2,249,088.00	2,351,722.00
	ARSIMI			
1	Çerdhet	45,000.00	50,000.00	50,000.00
2	Mësimi joformal SHMP "Bahri Haxha"	15,000.00	14,000.00	14,000.00
3	Mësimi joformal SHMT "Lutfi Musiqi"	14,000.00	13,000.00	13,000.00
II	Totali - Arsimi	74,000.00	77,000.00	77,000.00
	TË ARDHURAT NGA SHËNDETËSIA			
1	Shëndetësia primare	50,000.00	50,000.00	50,000.00
2	Shërbimet sociale	2,000.00	2,000.00	2,000.00
III	TOTALI SHËNDETËSI	52,000.00	52,000.00	52,000.00
Kodi 21	TOTALI I TË ARDHURAVE VETANAKE TË KOMUNËS (I+II+III)	2,262,795.00	2,378,088.00	2,480,722.00



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari i Komunës



RAPORT
PËR SITUATËN EKONOMIKE FINANCIARE DHE ZBATIMIN E PLANEVE
INVESTUESE PËR GJASHTËMUJORIN E PARË 2021

Shtator 2021

Të ndruar anëtarë/e të Kuvendit të Komunës,

Në këtë vit sikurse edhe në raportimet e mëhershme për me situatën ekonomike e financiare dhe zbatimin e planeve investuese, edhe në këtë raport jemi bazuar në planifikimin që është bërë si për projektet prioritare ashtu edhe për punët dhe aktivitetet tjera të komunës për secilën drejtori dhe sektorë me qëllim të përmbushjes së objektivave të përcaktuara me planifikimin me planet e tyre të punës si dhe planin e punës së kuvendit, në bazë të të cilit kryetari i komunës ka për obligim që të raportoj para kuvendit së paku dy herë brenda një viti kalendarik.

Edhe këtë vit gjegjësisht periudhë e gjashtëmujorit të parë na kanë përcjellë problemet me pandeminë COVID-19 dhe pasojat nga kjo pandemi.

Duke qenë se me vendimet tona i kemi liruar disa kategori të bizneseve dhe qytetarëve nga detyrimet që i kanë pas ndaj komunës, e gjithë kjo është reflektuar edhe në realizimin e të hyrave të planifikuara buxhetore. Kjo situatë për sa i përket përhapjes së virusit COVID-19 siç e dimë është duke vazhduar edhe tani dhe me pasoja për shëndetin dhe jetën e popullatës si dhe ekonomisë në komunën tonë.

Tani do të fokusohemi në punët që janë bërë brenda këtij gjashtëmujori në secilën drejtori veç e veç:

Buxheti dhe Financa

Në fillim të vitit 2021 janë evidentuar obligimet e pa paguara nga viti i paraprak që kanë qenë në shumë prej: 435,273.38 €, janë bërë barazimet me sistemin e free balancit dhe janë hartuar pasqyrat financiare për vitin fiskal 2020.

Është bërë bartja e të hyrave të pa shpenzuara nga viti 2020 që kanë qenë në shumë prej 1,789,251.83 €.

Janë pranuar gjithësejt 965 fatura të cilat brenda ditës janë dorëzuar në prokurim dhe te zyrtarët tjerë përgjegjës.

Në muajin mars janë paraqit në Kuvend bartjet e të hyrave të pa shpenzuara nga viti paraprak.

Në majin prill komform ligjit, janë bërë raportimet në kuvend për tre mujorin e –I- për të hyrat dhe shpenzimet.

Në majin maj kemi marrë qarkoren buxhetore 01/2022 nga MF me kufijtë e caktuar dhe së bashku me të gjitha drejtoritë kemi harmonizuar kërkesat për vitin 2021.

Në muajin qershor e kemi dorëzuar në Kuvend kornizën afatmesme të buxhetit për vitet 2022-2024.

Drejtoria për buxhet dhe financa ka inkasuar pjesës më të madhe të hyrave komunale nga tatimi në pronë. Realizimi i këtyre të yrave për këtë periudhë ka qenë në shumën prej 449,080.72 € ose 97.30% e shumës së planifikuar, kurse në krahasim me vitin e kaluar kemi inkasua më shumë të hyra për 178,101.04 € ose 65.72%.

Të hyrat vetanake të planifikuara për tatimin në pronë kanë qenë në shumën prej 461,562.00 €, kurse janë realizuar 449,080.72 € ose 97.30%

Planifikimi i buxhetit Janar-Qershor/2021 është si në vijim

- Paga dhe mëditje..... 5,252,284.40€
 - Mallra dhe shërbime..... 2,602,360.47€
 - Shpenzime Komunale..... 207,294.22€
 - Subvencione dhe transfero..... 849,904.93€
 - Investime kapitale..... 4,662,716.28€
- Totali..... 13,574,560.30€**

Forma tabelore: Buxheti i planifikuar dhe shpenzimet e realizuara

Përshkrimi	Kodi	Periudha raportuese(Janar-Qershor 2021)		
		Buxheti i planifikuar	Shpenzimet të realizuar	Përqindja e buxhet të realizuar
		4	5	6 = 5/4*100
		€	€	%
Paga dhe mëditje	111	5,252,284.40	5,243,834.40	100%
Mallra dhe shërbime	130	2,602,360.47	1,240,294.31	48%
Shpenzimet komunale	132	207,294.22	171,413.21	83%
Subvencionet dhe transferet	200	849,904.93	320,380.75	38%
Investimet kapitale	300	4,662,716.28	639,558.43	14%
TOTALI		13,574,560.30	7,615,481.10	56%

Ekonomi Bujqësi Pylltari

Sektori i bizneseve

Nr.	Përshkrimi i aktivitetit	Nr.	Vërejtje
1.	Biznese të reja (të regjistruara) individuale dhe SH.P.K	186	
2.	Biznese të shuara	25	

Sektori i bujqësisë

Gjatë këtij gjashtë mujorit në sektorin e bujqësisë janë zhvilluar një numër i aktiviteteve të bazuara kryesisht në planin e punës për vitin 2021.

Projektet e realizuara gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2021 :

1. Projekti në bashkëfinancim me organizatën IADK - “Fuqizimi i të rinjve dhe grave të zonave rurale për përfshirje në bujqësi dhe përpunim të ushqimit”;

Ky projekt është në fazën e implementimit, ku do të jenë 9 përfitues:

- Serra prej sipërfaqe 1 ari për 2 përfituese në fazë të montimit.
- Paisje për bletari 3 përfituese,(në proces).
- Pasje për blegtori 4 përfitues, (në proces).
- Përpunimi i pemëve dhe perimeve(në proces).
- Përpunimi i qumështit, (në proces).

2. Projekti: Furnizimi me paisje për bletari është në fazën e implementimit.

Nr.	Lloji i investimit	Nr.i përfituesve	Participimi	Komuna	Shuma
1	Paisje për bletari	48	200x48= 9600€	40,000.00€	49,600.00€

3. Projekti: Furnizimi me frezë për traktorë , është në proces, është bërë thirrja, janë caktua kriteret, numri i përfituesve.

Nr.	Lloji i investimit	Nr.i përfituesve	Participimi	Komuna	Shuma
1	Frezë për traktorë	36	200x36=7200€	30,000.00 €	37,200.00€

4. Projekti: Furnizimi me motokultivatorë, është në proces, është bërë thirrja, janë caktua kriteret, numri i përfituesve.

Nr.	Lloji i investimit	Nr.i përfituesve	Participimi	Komuna	Shuma
1	Motokultivatorë	50	150x50=7500€	28,000.00€	35,500.00€

Sektori i pylltarisë

Nr.	PËRSHKRIMI	VENDI	Gjithësejt Janar - Qershor
1	Kerkesa-per leje	Pranë zyres	44
2	Kerkesa te kryera	ZK-APK- Mitrovicë	15=538.31m ³
3	Damkosje dru zjarri	ZK-APK- Mitrovicë	538.31m ³
4	Fl-percjellje P-Private	Sektori i Pylltarisë	11 flp=20.00m ³
6	Fl-Pagesa P- private	Sektori i Pylltarise	11=722.70
9	Konfiskime	Sektori-Policia	5=32.40m ³
10	Gjendja ne depo	Pranë Sektorit	81.30m ³
12	Fl-paraqitje k-vajtje	Sektori-Gjykata	51=91.54m ³ =12601.81€
13	Fl-paraqitje penale	Sektori-Gjykata	5=22.88m ³ =3198.24€
14	Gjithsejt k-vaj-dhe penale	Sektori-Gjykata	56=114.42m ³ =15800.05€
15	Kontrolla ne terene	Sektori-Policia	49

Masa drunore në sasi prej 48.90 m³ është e bartur nga viti 2020 në vitin 2021. Të konfiskuara në vitin 2021 janë 32.40 m³. Gjithsejt gjendja në depo është 81.30 m³, të cilat muajin e kaluar përmes zyres së prokurimit i kemi proceduar për shitje.

Prokurimi Publik

Në Raport janë përfshirë aktivitetet e punës të Drejtorisë Komunale për Prokurim në realizimin, Planit të Punës, detyrave dhe objektivave të saja gjatë viti 2021. I tërë aktiviteti i prokurimit i realizuar është bazuar në dispozitat e Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik në Kosovë.

Parimet bazë mbi të cilat mbështetet aktiviteti i prokurimit janë parimi i ekonomicitetit (vlerës për paranë), efikasitetit, transparencës. Duke zbatuar këto parime, është synuar që në të gjitha aktivitetet e prokurimit të realizuara në drejtori, të sigurohet që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën sa më ekonomike, sa më efikase, më transparente dhe më të drejtë, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, poashtu që fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion sipas një kontrate publike të mundë të përdoren nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njejtës.

Në periudhën raportuese, Drejtorja, konform dispozitave ligjore që rregullojnë lëmin e prokurimit, ka iniciuar dhe realizuar prokurime për t'i realizuar dhe përmbushur kërkesat për gjitha shtyllat e buxhetit të Autoritetit Kontraktues, si vijon: Administratë Komunale, Arsim, Shëndetësi, Njësia e Zjarrfikësve, Zyra lokale e komuniteteve dhe Shtëpia Rezidenciale në Lum Madh.

Në bazë të LPP-së autoriteti kontraktues mundë që gjatë ushtrimit të një aktiviteti të prokurimit dhe varësisht nga natyra – lënda dhe vlera parallogaritare e prokurimit, të shfrytëzoi njërën nga procedurat, si vijon :

1. Procedurë e hapur dhe e kufizuar
2. Procedura konkurruese me negociata
3. Procedurë e negociuar pa publikimin e njoftimit të kontratës
4. Procedurë e kuotimit të çmimeve, dhe
5. Procedurë për kontratat me vlerë minimale.
6. Konkursi i projektimit

Edhe gjatë kësaj periudhe Janar-Qershor 2021 Drejtorja ka pasur për synim t'i përmbushë gjitha kërkesat përkatësisht t' i procesoi dhe kontrakttoi gjitha projektet - prokurimet e parashikuara me Planifikimin përfundimtarë të aprovuar nga organet kompetente, kuvendi i komunës. Në vazhdim janë paraqitur të dhënat lidhur me realizimin e Planifikimit të prokurimeve për vitin 2021, dhe gjendja aktuale është si në tabelën vijuese:

PËRQINDJA E REALIZIMIT TË PLANIT TË PROKURIMIT SIPAS DREJTORIVE JANAR- KORRIK

NKK Vushërr		FURNIZIME/SHERBIME/PUNE			
Nr. rendor	Emri i Zyres / Drejtorise	Pasqyues	lekar	mbetur	Në përqindje
1	ZYRA EKSPEDIT	1	0	1	0
2	ZYRA EKSPEDIT	3	2	1	66.67
3	DREJTORIA PER APSIM	42	29	13	69.05
4	DREJTORIA PER URBANIZIM	5	1	4	20.00
5	DREJTORIA PER ADMINISTRAT	7	6	1	85.71
6	DREJTORIA PER SHERBIME PUBLIKE	10	8	2	80.00
7	DREJTORIA E BUDZES	9	1	8	11.11
8	DREJTORIA E KULTURES	7	3	4	42.86
9	DREJTORIA PER INSPEKTIVE	5	4	1	80.00
10	DREJTORIA E BUDZHETIT	2	1	1	50.00
11	DREJTORIA PER MBROJTJE DHE SHPETIM	1	0	1	0.00
12	DREJTORIA PER KADASTER DHE GJEODEZI	3	1	2	33.33
13	DREJTORIA E SHENCETESISE/CHMP	13	3	10	23.08

Administratë

Zyra e Gjendjes Civile

Gjatë kësaj periudhe janë shqyrtuar dhe kryer të gjitha kërkesat e qytetarëve si dhe janë dhënë këto shërbime:

Lëshimi i certifikatave dhe dokumenteve të gjendjes civile gjithsej 30621, ndërsa regjistrime të fakteve të lindjeve dhe të vdekjeve 216 raste.

Janë kryer 305 kurorëzime të qytetarëve dhe janë regjistruar 27 martesë të lidhura jashtë Kosovës.

Janë pranuar nga gjykatat dhe janë zbatuar në regjistrin qendror të gjendjes civile 50 Aktgjykime për shkurorëzimin e martesave.

Numri i dokumenteve të lëshuara

Nr.	Përshkrimi	Lëshuara
1.	Ekstrakt i lindjes	15231
2.	Certifikata të lindjes	4487
3.	Certifikata të martesës	3255
4.	Certifikata të vdekjes	2252
5.	Certifikata të Statusit martesor	990
6.	Certifikata të shtetësisë	151
7.	Certifikata familjare	2067
8.	Certifikata të vendbanimit	1285
9.	Vërtetim nga arkivi	439
10.	Dëshmi e vdekjes	179
11.	Deklarata e Atësisë dhe Amësisë	36
12.	Lajmërim dhe Ç'lajmërim i Vendbanimit	95
13.	Vendime të ndryshme	71
14.	Aplikimi për humbje të shtetësisë me lirim	43
15.	Aplikimi për natyralizim	8
16.	Deklarata për mbajtje	18
17.	Vendime për ndërrimin e emrit personal	14
	Gjithsejtë	30621

Regjistrime në Regjistrat e Gjendjes civile

1	Regjistrime të lindjes	136
2	Martesa	305
3	Regjistrime të vdekjes	248
4	Regjistrime të Shtetësisë	4
5	Regjistrime të lindjes jashtë shtetit	58
6	Regjistrime të martesës jashtë shtetit	27
7	Regjistrime të vdekjes jashtë shtetit	22
Gjithsejtë regjistrime të bëra		800

Ne këtë periudhë janë verifikuar **1068** qytetarë në sistemin e ri të gjendjes civile, ndërsa qe nga fillimi i sistemit te ri, janë te verifikuar apo te regjistruar ne sistemin e gjendjes civile **99582** qytetar të komunës së Vushtrrisë.

Njësi Komunal për të Drejta të Njeriut

Për shkak të pandemisë aktiviteti dhe puna e njësit është përgjysmuar apo thuajse është simbolike, si:

- Pjesëmarrja në mbledhjen e KKSB;
- Dërgimi i statistikave në ABGJ lidhur me regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve;
- Takim në zyre me palët e komunitetit rom;
- Vizitë në gjimnazin "Eqrem Çabej";
- Vizitë në 10 shkolla fillore në komunën e Vushtrrisë;
- Takim në Stacionit Policor rreth disa statistikave të kryesve të veprave penale gjatë periudhës 2020;
- Formimi i Mekanizmit Komunal Kundër Dhunës ndaj Gruas;
- Takim me ZOOM grupin punues për hartat Zonale në komunë organizuar nga GIZ
- Vizitë komunitetit ashkali në Vushtri;
- Takim ZOOM me IADK, Analiza gjinore e pjesëmarrjes së grave në bujqësi;
- Takim me ZOOM me grupin punues për Planin për pjesëmarrje të qytetarëve;
- Takim me ZOOM organizuar nga IKAP, tema aftësimi i fitimit të njohurive në procesin e negociatave me BE, për marrjen e Statutit kandidat;
- Mbajtja e tri takimeve punuese për hartimin e Strategjisë Kundër Dhunës në Familje;

Shërbime Publike

Furnizimi me ujë

Pas finalizimit dhe lëshimit në funksion të fabrikës së ujit, kemi qenë të orientuar në kyçjen e të gjitha ekonomive familjare në rrjetin e ujësjellësit në të gjitha fshatrat e komunës, projekt ky i kontraktuar dhe në implementim e sipër. Në këtë projekt do të përfshihen rreth 9000 familje. Deri më tani kanë përfunduar disa fshatra prej të cilëve fshati Stanoc i Poshtëm, Stanoc i Epërm, Vilanc, Ropicë, Samadrexhë, Sfaraqak, Sllatinë, pjesa e mbetur e Smrekonicës, Bukosh, Novolan, Liqej, Taraxhë dhe pjesërisht Vërnice, Reznik, Dërvar dhe Mihaliq. Gjithashtu kemi qenë të orientuar në ngritjen e kapaciteteve menaxhuese të kësaj fabrike si dhe krijimin e TASK FORCES për eliminimin e keqpërdorimit të ujit të pijes në mënyrë që të kemi furnizim më të rregullt me ujë.

Largimi i ujërave të zeza

Në infrastrukturën e rrjetit të kanalizimit po ashtu janë bërë investime të shumta sidomos në shtrirjen e rrjetit primar kryesisht për gjatë lumenjve në një numër të konsiderueshëm të fshatrave. Janë këto projekte dy vjeçare të kontraktuara në këtë fillim vit, implementimi i të cilave është duke u bërë me një dinamikë të kënaqshme. Deri më tani është bërë rregullimi i kanalizimit në fshatin Pestovë, Dërvar, Maxhunaj, Dobërllugë dhe Bajsk për të vazhduar pastaj me fshatrat pjesë të kontratës.

Largimi i ujërave atmosferike

Në kuadër të planit të punës së drejtorisë, me planin financiar, është paraparë që të intervenohet në pastrimin e pushtave të kanalizimit atmosferik. Gjatë kësaj periudhe është bërë pastrimi i ujëmbledhëseve të prrockave dhe rrjedhave të ujit në qytet, përmes kontratës me Ndërmarrjen UNITETI.

Menaxhimi i Mbeturinave

Në fushën e menaxhimit të mbeturinave, është bërë rishikimin e planit pesëvjeçar për menaxhimin e mbeturinave brenda territorit të Komunës së Vushtrrisë. Si rezultat i këtyre angazhimeve, Komuna e Vushtrrisë është duke bërë ofrimin e shërbimit për të gjitha vendbanimet e komunës. Gjithashtu është duke u bërë grumbullimi i ndarë i mbeturinave te rreth 1500 ekonomi familjare, të cilat janë duke u paketuar në qendrën për paketim në Bukosh. Në garat për “Mjedis të Pastër” Komuna e Vushtrrisë në vazhdimësi i ka plotësuar kriteret e qasjes ndaj këtyre fondeve dhe ka përfituar mjete të konsiderueshme nga GIZ-ja e cila ka zhvilluar procedurat e tenderimit dhe shumë shpejtë do të furnizohemi me një numër kompaktorësh për grumbullim dhe deponim të mbeturinave, ndërsa nga Granti i Performancës Komuna e Vushtrrisë ka përfituar vlerën prej 284,856.32 €. Po ashtu është bërë eliminimi i qëndrueshëm i deponive ilegale dhe aktualisht i kemi vetëm gjashtë deponi të tilla.

Pra tërë këto aktivitete përbëjnë fushatën më të madhe mjedisore që për synim kanë mbulueshmërinë me shërbim të tërë territorit të Komunës së Vushtrrisë, eliminimin e qëndrueshëm të deponive ilegale, rritjen e shkallës së inkasimit përmes mekanizmave kushtëzues që parasheh rregullorja për menaxhim të mbetjeve, si dhe zvogëlimin e sasisë së mbetjeve që deponohen, përmes promovimit të ndarjes së tyre në burim apo promovimit të 3R, si dhe procesit të kompostimit.

Si rezultat i këtij angazhimi ndërmarrjes „UNITETI” i është siguruar një stabilitet financiar dhe kemi arritur që në masë të madhe ta përmirësojmë gjendjen e ambientit.

Ndriçimi publik

Ka vazhduar implementimi i kontratave për zgjerim dhe mirëmbajtje të rrjetit të ndriçimit, me ç’rast një numër i konsiderueshëm i lagjeve tashmë posedojnë ndriçimin publik duke përfshirë edhe Memorialin e Dëshmorëve në Dumnicë të Poshtme.

Gjithashtu në realizim e sipër kanë qenë; ndërtimi i shtratit të lumit Podrança projekt dy vjeçar, ndërtimi i katër urave dy në fshatin Dumnicë dhe dy në fshatin Smrekonicë.

Në fushën e mirëmbajtjes së gjelbërimit me sukses janë realizuar projektet e planifikuara, si:

- Furnizimi dhe mbjellja e luleve dekorative;
- Plani për pastrimin, mirëmbajtjen dhe kultivimin e parqeve të qytetit;

Komunikacion

Në kuadër të fushës së trafikut, është menaxhuar kontrata për shërbimet e transportit me auto merimangë, janë nxjerrë vendime për bllokim të shiritave rrugor dhe vendime për shfrytëzim të parkingjeve nga operatorët e transportit të udhëtarëve me Radio Taksi, vendime për ndaljen e mjeteve motorike për ngarkim shkarkim.

Në fushën e trafikut ka vazhduar implementi i kontratës për furnizim dhe vendosje të sinjalizimit horizontal dhe vertikal në rrugët e qytetit, me qëllim të krijimit të një rrjeti funksional dhe të integruar, duke synuar rritjen e shkallës së sigurisë për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion, pra krijimin e kushteve për lëvizje të motorizuara dhe të pa motorizuara, duke përfshirë edhe personat me nevoja të veçanta.

Po ashtu janë proceduar kontratat për mirëmbajtje dhe rikonstruim të rrugëve të asfaltuara dhe kontrata për mirëmbajtje dimërore të rrugëve lokale, ndërsa nga kontrata për mirëmbajtje të rrugëve të rendit të IV-të, është nënshkruar kontrata dhe pritet të fillojnë punimet në mirëmbajtje të këtyre rrugëve.

Arsimi

DKA objektivat e veta të planifikuara i ka realizuar në bashkërenditje të ngushtë me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI-Prishtinë), me Sektorin e Inspektiveve në Mitrovicë, si dhe me partnerë të jashtëm të arsimit.

- Sigurimi dhe zhvillimi i cilësisë dhe aktivitetet gjithëpërfshirëse

DKA – ka bërë një vlerësim dhe analizë të përgjithshme, për ecurinë dhe performancën e procesit edukativo-arsimor dhe analizën e suksesit të nxënësve për rezultatet e arritura, për të tri nivelet e arsimit parauniversitar, duke krahasuar rezultatet e suksesit me rezultatet e periudhës së njëjtë të vitit paraprak.

Gjatë gjithë kohës shkollat kanë pasur material të bollshëm antikovid.

Gjatë vitit pandemik që përfshin edhe këtë periudhë 6 mujore nuk kanë pasur mundësi ta vijnë mësimin online 165 nx. ose 1.23%, kanë qenë të prekur me covid-19; 297 mësime të mësuara ose 33.75 % , ka vdekur 1 mësime të mësuara dhe 1 punëtor teknik, nxënës të infektuar 223 ose 1.67%.

Janë zhvilluar mentorime në të gjitha shkollat e Komunës së Vushtrrisë, e që në objektivat kryesor kishin fushën e menaxhimit dhe qeverisjes së shkollës në funksion të sigurimit të cilësisë

Është mbajtur pilot testi PISA me nxënësit e SHMT "Lutfi Musiqi" Vushtrri, testi PIRLS me klasat e IV-ta, në 6 shkolla të komunës së Vushtrrisë ("Naim Frashëri", "A.Z.Çajupi", "Ali Kelmendi", "Liria", "Bahri Kuqi", "Mustafë Venhari", testi nga Instituti Pedagogjik për klasat e dyta dhe të shtata në SHMU-2, "Hajrullah Shala", "A.Z.Çajupi", "Naim Frashëri" rreth studimit: Ndikimi i COVID-19 në humbjet mësimore, pasoja në rritjen e pabarazisë në mësim dhe sfidat e përmbushjes/kompensimit.

Janë mbajtur garat sportive në nivel komunal, regional dhe në nivel shteti; të arritura në nivel shteti: SHMU-2 basketboll F. vendi i tretë, SHMT "Lutfi Musiqi" basketboll M. vendi i parë, hendboll: F. SHFMU "Lumni Surdulli" vendi i parë, SHMU-2 M. Vendi i dytë, Gjimnazi F. vendi i parë. Fustall SHMU-1 M. vendi i parë, Voliboll: SHMP " Bahri Haxha" Vushtrri M. vendi i dytë.

Janë mbajtur garat në nivel komunal në esë : vendin e parë SHFMU " A.Z.Çajupi" Vushtrri. Nxënësit e SHMT "Lutfi Musiqi" kanë fituar grantin nga Korpuesi i Paqes.

Janë mbajtur garat komunale në lëndën e fizikës dhe të matematikës: Fizikë në nivel vendi: Gjimnazi vendi i dytë edhe më klasë të XII-të dhe më XI-të.

Kanë qenë në funksion 34 vija transporti për nxënës të cilët udhëtojnë mbi 4 km.

Është hapur objekti i ri në SHFMU "Migjeni" Stanoc të Epërm. Është hapur objekti i ri i shkollës së muzikës.

Bibloteka e re në SHFMU "Migjeni" në Stanoc të E. për nxënës dhe qytetarë.

Është shtuar shërbimi profesional me 3 pedagogë në shkolla.

Janë pajisur me 146 lllaptop shkollat.

Çerdhja e re afër SHFMU "Mustafë Venhari" është inventarizuar dhe fillon punën në shtator.

Çerdhja e re afër SHF "Ali Kelmendi" është në përfundim të punimve.

Salla sportive në SHMU-2, janë duke u kryer punimet e vrazhda.

Salla sportive në SHMU-1, është në finalizim të punimve.

Ka përfunduar punëtorja në shkollën e mesme teknike dhe nga shtatori është e gatshme për praktikë profesionale .

Rregullimi i hapësirës së oborrit të shkollës në SHFMU- Lumadh.

Janë zgjedh 12 shkolla më mjedis miqësor kundër abuzimit të fëmijëve.

Vendosja e muralit në qytet me qëllim edukativ dhe vetëdijesues kundër abuzimit të fëmijëve.

Janë nda 69 bursa për të gjithë studentët të cilët kanë notën mesatare mbi 8.

Janë mbjell 362 dru dekrektiv për shkolla.

Janë ndarë 27 shpërblime për nxënës.

Janë kryer 29 pagesa për transport për fëmijë më nevoja të veçanta.

I. Testi i arritshmërisë

Viti	2018	2019	2021
%	52.05	49.43	49.78

Vërejtje: testi i arritshmërisë nuk është mbajtur në vitin 2020 për shkak të pandemisë kovid-19 .

II. Testi i maturës

Gjimnazi "Eqrem Çabej" Vushtri:

Viti	2019	2020	2021
%	96.10%	87.95%	93.14%

SHMP "Bahri Haxha" Vushtri

Viti	2019	2020	2021
%	25.30%	39.53%	48.38%

SHMT "Lutfi Musiqi" Vushtri

Viti	2019	2020	2021
%	25.00%	40.70%	31.00%

III. Suksesi dhe krahasueshmëria në periudhën e njëjtë

Gjysmë vjetori i dytë	Suksesi nga klasa e I- V					
	Shkëlqyeshëm	Sh. Mirë	Mirë	Mjaftueshëm	Të pamjaftueshëm	Të panotuar
2021	68.0%	18.6%	10.5%	2.9%	0.0%	0.3%
2020	69.6%	17.7%	9.8%	2.8%	0.0%	0.0%
Krahasueshmëria	-1.6%	0.9%	0.7%	0.1%	0.0%	0.3%

Suksesi kl.I-V		
GJ.II , Periudha e njëjtë	Pozitiv	Negativ
2021	5115	0
2020	5231	0
Krahasueshmëria		

GJ.II , Periudha e njëjtë	Suksesi nga klasa e VI- IX					
	Shkëlqyeshëm	Sh. Mirë	Mirë	Mjaftueshëm	Të pa notuar	Të pamjaftueshëm
2021	29.7	22.6	26.4	17.6	0.01	1.25
2020	34.4	23.2	28.2	13.8	0.2	0.1
Krahasueshmëria	-4.7	-0.6	-1.8	3.8	-0.2	1.1

Suksesi kl.VI-IX		
GJ.II , Periudha e njëjtë	Pozitiv	Negativ
2021	3954	154
2020	4247	5
Krahasueshmëria	-293	149

GJ.II , Periudha e njëjtë	Gj.II viti shkollor 2020/2021 X-XII					
	Shkëlqyeshëm	Sh. Mirë	Mirë	Mjaftueshëm	Të pa notuar	Të pamjaftueshëm
2021	12.3	18.6	30.2	3.1	0.03	3.1
2020	15.3	21.4	34.3	25.6	0.1	3.2
Krahasueshmëria	-3.0	-2.8	-4.1	-22.5	-0.1	-0.1

Suksesi kl.X-XII		
GJ.II , Periudha e njëjtë	Pozitiv	Negativ
2021	2276	259
2020	2603	87
Krahasueshmeria	-183	-30

Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale

- Kemi siguruar pajisje mjekësore moderne për shërbimin e urgjencës
- Ka përfunduar ndërtimi i objektit të laboratorit në fshatin Lumadh.
- Po ashtu 25 000 € janë blerë pajisje mjekësore për laboratorë.
- Kemi subvencionuar 329 fëmijë të porsalindur me nga 120 Euro.
- Nga fondi i subvencioneve kemi ndihmuar një numër të konsiderueshëm të rasteve me sëmundje të rëndë shëndetësore dhe rasteve sociale.
- Kemi siguruar donacion një Autoambulancë nga Suedia për nevojat e QKMF-së.
- Kemi filluar punimin e analizave laboratorike që nuk janë punuar në laboratorin e Vushtrisë deri me tani D-Dimeri, HbA1C, faktori reumatik, elektroliti, CPR,, testet serologjike dhe fraksionet e yndyrave.
- Në përfundim e sipër është Qendra e Mjekësisë Familjare në zonën urbane të tregu aktual që do të ndikojë pozitivisht në zoonimin e qytetit në aspektin e marrjes së shërbimeve mjekësore. Kjo qendër synohet të bëhet Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare dhe do të ofrojë hapësirë dhe kushte shumë të mira për pacientet dhe personelin shëndetësor.
- Kemi fuqizuar dhe rritur kapacitetet e shërbimit të terrenit për rastet e sëmundjeve kronike, lehonat si dhe fëmijët e porsalindur nga marrëveshja që kemi me Islamic Relief.
- Jemi duke dhënë maksimumin për të qenë sa më afër qytetarëve dhe menaxhimit më të mirë të situatës me pandeminë. Ekipet tona po vazhdojnë t'i vizitojnë rastet e prekura, t'i furnizojnë me terapi simptomatike, dhe kontaktojmë vazhdimisht përmes telefoni e po ashtu kemi ndarë hapësirë të veçantë për trajtimin e rasteve të prekura me virusin Covid-19.

- Tani kemi filluar edhe vaksinimin masiv të qytetarëve .
- Kemi dyfishuar buxhetin për barna dhe reagensë për analiza laboratorike në mënyrë që të ofrohet furnizim më i mirë për pacientet si dhe shërbime të reja.
- Jemi në procedurë e sipër për blerjen e pajisjeve të reja mjekësore të nevojshme për QKMF-në.

Janë realizuar vizita e shërbime mjekësore për pacientët e komunës tonë me kapacitet të plotë .

Në shërbimin e mjekësisë familjare janë vizituar dhe kanë marr shërbime shëndetësore si para Covid-it. Gjithçka që përcaktohet me UA/ 04.2020 në të gjithë sektorët e mjekësisë familjare si vizita mjekësore, konsulta, shërbime tjera si: infuzion, tretman, inhalim, këndi rehidrim, pastrim plagësh e fashim etj.

Në sektorin e Stomatologjisë janë ofruar konsulta, vizita, rregullim dhëmbësh, pastrim të gurëzve, RTG për dhëmb dhe nxjerrje, këto vizita dhe shërbime ofrohen në QKMF dhe në 5 QMF tjera.

Vaksinimi në vazhdimësi arrijmë rezultate të mira në vaksinimin e fëmijëve dhe të tjerëve që kanë nevojë për vaksinim/imunizim. Gjatë këtij viti ka fillua edhe imunizimi me vaksinën anti Covid, ku po bëhet një punë e madhe në vaksinimin e qytetarëve, me staf jemi përkrahur nga M.SH, vaksinimi po shkon mirë me interesim mesatar të qytetarëve, pa fluks e tollovi të madhe. Terminet po caktohen në platformën online Kosova apo edhe në QKMF.

Urgjenca punon 24^h dhe ofron shërbime shëndetësore për qytetarët në çdo kohë kur ata kanë nevojë për shërbime urgjente, po ashtu ofrohet edhe transporti për pacientët e sëmur rënd e që kanë nevojë të transportohen me autoambulancë në shërbimin sekondar në rastet kur ata referohen nga mjeku.

Diagnostika; Laboratori i cili gjatë këtij viti ka ofruar shërbime të shumta për qytetarët e Vushtrrisë, numri i analizave dhe testeve laboratorike ka qenë i madh krahasuar me vitet tjera edhe për shkak të testeve për diagnostifikim të Pandemisë si (testet serologjike, teste rapide, D-Dmer), dhe realizimi i të gjitha analizave të përcaktura me UA/04.2020, për laboratorin në KPSH, përveç elektrolitëve që patëm vështirësi disa herë në punimin e tyre dhe shpejt duhet që të rinisën të punohen.

Në laborator kemi pasë disa vështirësi teknike por mendojmë që s’shpëjti do të rregullohen.

Shpejt pritet hapja e dy laboratorëve në QMF Lummadh dhe në QMF 3, të cilët do ndikojnë në përmirësim e qasjes dhe të cilësisë së shërbimeve shëndetësore

Kabineti i RTG – Në fillim të vitit patëm vështirësi për shkak të prishjes së aparatit të RTG, por DSHPS lidhi marrëveshje me spitalin “SH.Z”, për ofrimin e shërbimeve shëndetësore për pacientët e QKMF-së deri në rregullimin e aparatit të rentgenit. Pacientët tanë nuk patën problem në marrje të shërbimeve radiologjike pasi që edhe dy nga punëtorët tanë të rentgenit punuan aty.

Për fat të mirë Rtg në QKMF tani më është funksionale dhe ofron shërbime për qytetarët komunës tonë.

Këshillimorja për sëmundje kronike jo ngjitëse me theks te veçantë Hipertension dhe Diabet e që pritet të zgjerohet me sëmundje tjera te shpeshta si Astma etj. Këshillimorja pacientit i ofron edukim shëndetësor dhe disa shërbime mjekësore si matje te TA, Glikemisë dhe ofrim i këshillave për mirëmbajtje të tensionit dhe Diabetit në nivel të kënaqshëm me dietë dhe me marrje të rregullt të terapisë .

Projekti i Ministrise se shëndetësisë i ndihmuar nga UNICEF me trajnime për stafin shëndetësor ne ofrimin e vizitave ne shtëpi për nëna dhe fëmijë deri në moshën 3 vjeçare ka rezultate shumë të mira duke ofrua konsultime për rritjen e shëndetshme të foshnjave, rëndësin e gjidhënjes etj.

Projekti Islamik Reliev/komunë ofron shërbime shëndetësore për personat me sëmundje të rënda kronike dhe ato terminale, që nga fillimi i këtij projekti është lehtësuar jeta pacientit dhe familjes së tijë për shkak shërbimeve që ofrohen në shtëpinë e të sëmurit dhe ka përmirësuar kosto-efektivitetin e marrjes së shërbimeve për të sëmurët. Gjithësejt janë vizituar 12.646 pacient dhe janë dhënë 42.155 shërbime në teren nga punëtorët shëndetësor,.

Sëmundjet kronike :

Numri i sëmundjeve Malinje: **293 (të raportuar nga mjekët ne raporte mujore)**

Numri i sëmundjeve kronike: **7.077(të raportuar nga mjekët ne raporte mujore)**

Depoja qendrore farmaceutike:

Furnizimi nga Ministria e Shëndetësisë për fat të keq ka qenë jo i mirë e me shumë vështirësi sidomos në furnizim me insulina dhe medikamente nga lista Esenciale për KPSH, ndërsa ka pasë mjaftueshëm material shpenzues për mbrojtje nga virusi SARS COV 19.

Gjithësejt furnizim nga M.Sh ka qenë 65.170.55 euro për 6 muajt e parë të vitit 2021, ku pjesën më të madhe e kanë zënë insulinat. Furnizimi për 6 mujorin e parë të vitit 2020 ishte 96.991.22 euro, që don të thonë se për periudhën e njëjtë kemi ramje prej 32.80%, nga furnizimi total nga M.SH.

QKMF është përpjekur të plotësoi këto mungesa të terapisë dhe materialit shpenzues nga buxheti i komunës në vlerë 11.652.50 euro

Numri i përgjithshëm i pacientëve që kanë participuar është: **16,419** në vlerë **23,072.50 euro** .

Pacientët që kanë marrë certifikata shëndetësore është : **158 ose vlerë 2.844 euro**

Në vijim do gjeni tabelat me numrin e vizitave dhe shërbime shëndetësore!

<i>Nr</i>	<i>Emri i shërbimit</i>	<i>Totali</i>	<i>Meshkuj</i>	<i>Femra</i>	<i>participim</i>	<i>shërbim</i>	<i>referime</i>	<i>malinje</i>	<i>kronike</i>	<i>Te vizituar me karte</i>
1	QKMF	30551	14047	16504	4834	101098	3800	9	1391	997
2	Urgjenca	15792	7324	8468	1357	89789	2244	231	2971	0
3	Laboratori	10330	3961	6369	2076	118234	0	0	0	0
4	Stomatologjia	4666	2024	2642	498	23075	110	0	0	1714
5	RTG	1213	526	329	329	10164	0	0	0	0
6	Rtg e dhembit	300	131	169	47	715	0	0	0	0
7	Vaksinimi	2251	1204	1047	0	9340	0	0	0	2251
8	QMF-1	27697	13193	14504	5325	69065	3026	49	1330	657
9	QMF-2	2945	1285	1660	492	9978	560	0	121	390
10	QMF-3	2978	1283	1695	483	20289	46	0	411	1125
11	QMF-AMF	7026	3003	4023	978	31353	2148	4	634	490
12	V.SHTEPIAKE	1739	729	1010	0	27230	7	0	0	0
13	KshillimoreAQH	764	369	395	0	3001	0	0	219	294
	Gjithsejt;	108,252	49,079	59,173	16,419	513,331	11,941	293	7,077	7,918

Qendra për Punë Sociale

Asistenca sociale - në Asistencë Sociale janë 1447 familje, prej tyre 1396 familje me 7173 anëtarë janë shqiptarë si dhe 51 familje me 154 anëtarë janë minoritete.

Gjatë kësaj periudhe janë parashtruar 96 kërkesa për asistencë sociale prej të cilave 47 janë aprovuar, kurse 49 prej tyre janë refuzuar si familje të cilat nuk i kanë plotësuar kriteret. Ndërsa

janë riaktivizuar 12 familje.

Asistenca sociale i është ndërprerë 35 familjeve të cilat kanë qenë shfrytëzuese të kësaj ndihme.

Në komision mjekësor janë dorëzuar dhe trajtuar 287 aplikantë. Prej tyre janë aprovuar nga KM 251 aplikues, janë refuzuar 32, ndërsa në rishqyrtim kanë qenë 4 raste .

Janë shpërndarë ndihma në pako për shfrytëzuesit e ndihmës sociale përkrahur nga organizata të ndryshme.

Shërbimet Sociale - Në periodën raportuese krahasuar me vitin paraprak numerikisht numri i klientëve ka pësuar ngritje si rezultat i trajtimit të kategorive të reja.

Vlen të theksohet se gjatë kësaj periode kemi pasur 41 raste të trajtimit të bashkëshortëve me marrëdhënie të çrregulluara ose në procedurën e shkurorëzimit, ku prej tyre 11 kanë arritur pajtim dhe 6 ndarje.

Nga këto familje janë 21 fëmijë, prej tyre 15 i janë besuar nënës në kujdesje, ndërsa 9 ju janë besuar babait.

Fëmijët pa kujdes prindorë Kemi pasur 3 raste fëmijë të braktisur të bartur nga viti i kaluar kurse gjatë këtij viti kemi 2 fëmijë të braktisur, ku ju është caktuar kujdestari ligjor. Gjatë këtij viti kemi caktuar kujdestar ligjor për 12 raste, me rastet e bartura nga vitet paraprake gjithsej 36 kujdestari aktive. Strehim familjar 25 raste, të gjithë fëmijët që janë në strehim familjar tek të afërmit. Janë vizituar të gjitha rastet problematike, janë trajtuar në formën e duhur duke ju ofruar fëmijëve dhe familjeve seanca këshilluese e shërbime të tjera të nevojshme. Po ashtu kemi asistuar në gjykatë dhe kemi dhënë mendim për 2 raste - martesë e të miturve.

Urbanizëm dhe mbrojtje të Mjedisit

Gjatë periudhës Janar –Qershor 2021, kryesisht janë mbajtur takimet e organizuara nga sektori i planifikimit urban për çështjet e rregullimit urban, pjesëmarrja në konferenca të organizuara nga niveli qendror dhe grupe tjera kombëtare dhe ndërkombëtare, takimet e rregullta me komunitetet e zonave të ndryshme, propozimet e ndryshme për rregullim, takimet e rregullta me nivelin qendror rreth Ligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje.

DUMM ka zbatuar në përpikëri Planin Zhvillimor Komunal ku zyrtaret përgjegjës gjatë çdo shqyrtimi të kërkesave të pranuar që kanë të bëjnë me ndërtime dhe informime tjera rreth destinimit të parcelave kadastrale të tyre janë udhëzuar me destinimin e përcaktuar në Planin Zhvillimor Komunal po ashtu kërkesat e parashtruara për marrjen e Kushteve Ndërtimore, Lejeve Ndërtimore dhe Lejeve për Rrënimin e objekteve për kategorinë e parë dhe të dytë.

Sektori i Urbanizmit është marr me shqyrtimin e kërkesave që kanë të bëjnë me caktim të lokacioneve, kushtet e ndërtimit, lejeve ndërtimore për kategorinë I dhe II, pëlqimeve paraprake, lejeve për rrënimin e objekteve, leje përdorimi të objekteve, informacione për destinimin e sipërfaqeve nga planet përkatëse rregulluese duke kaluar nëpërmes procesit të daljes në teren dhe incizimit të gjendjes faktike në terren, ku përmes sektorit për planifikim urban e ka vazhduar procesin e mëtutjeshëm për finalizim si dhe punë të tjera në komisione siç janë: Shfrytëzime të hapësirave publike para lokaleve etj.

Legalizimet - Për dallim nga viti i kaluar ku ishim në gjendje pandemie këtë vit edhe pse jemi në një gjendje me masa të kufizuara kemi numër të madh të kërkesave të cilat janë në numër - njëqind e dyzet e katër (144) të parashtruara nga palët për legalizimin e objekteve për kategorinë I-rë dhe të II-të të ndërtimit, prej tyre janë shqyrtuar njëqind e njëmbëdhjet (111) nga stafi i kësaj drejtorie.

Gjatë kësaj periudhe kërkesat në fjalë janë trajtuar si më poshtë:

KUSHTET NDËRTIMORE		
1	Kushtet Ndërtimore të caktuara	23
2	Në proces	4
3	Informime për plotësime të lëndës	16
4	Informime nga Plani dhe procedimi i kërkesave për ndërrimin e destinimit të tokës nga toka bujqësore në tokë ndërtimore	10
5	Refuzime	3
6	Lëndë të Hedhura Poshtë	6

Lejet ndërtimore: Janë lëshuar: 10 Leje ndërtimore; Çertifikata që posedon Leje Ndërtimore 5 ;

-Leje rrënimi 4.

Taksat e inkasuara për Leje Ndërtimore dhe Leje Mjedisore Komunale përfshinë vlerën:
124113.97€

Sektori për planifikim urban – gjatë kësaj periudhe është bërë sistematizimi i lendeve të ndryshme, koordinimi profesional dhe ligjor brenda drejtorisë, zbatimi i Planit Zhvillimor Komunal, kontrollimi i rregullt i projekteve kapitale, zgjidhje dhe përgjigje të kërkesave të qytetarëve, përgatitja e projekteve konkurruese ideore, vizitat e punimeve në teren-mbikëqyrja e projekteve, monitorimi dhe

aprovimi për kushte dhe leje ndërtimore, pranime teknike të disa projekteve, mbajtja e disa seminareve të organizuara nga organizata të ndryshme, Takimet me grupet punuese dhe UN-Habitat-in etj.

Sa i përket Investimeve kapitale, jemi duke i realizuar punimet sipas projekteve të parapara për realizim:

- Asfaltimi i rrugëve në qytet
- Asfaltimi i rrugëve në fshatra
- Rindertimi i rrugës “Isa Boletini” sipas projektit Ecje në Histori.

Sektori për mbrojtje të mjedisit-

Drejtoria ballafaqohet me një numër mjaft të vogël të stafit e cila e bënë të pamundur zbatimin sa më efikas të detyrave dhe përgjegjësisive përkatësisht në sektorin e mbrojtjes së mjedisit ku jemi vetëm me një zyrtar të vetëm. Në respektim të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Udhëzimit Administrativ për dhënien e Lejeve Mjedisore Komunale kemi shqyrtuar kërkesa të palëve kemi lëshuar tetë (8) Leje Mjedisore Komunale .

Kulturë Rini Sport

Qendra për Kulturë “Hasan Prishtina”

Stafi i Qendrës për Kulturë “Hasan Prishtina” gjatë këtij viti ka mbështetur apo organizuar të gjitha aktivitetet kulturore që janë organizuar nga institucionet komunale. Po ashtu, ka ndihmuar në organizimin e aktiviteteve të shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së dhe aktiviteteve të ndryshme në të cilat është kërkuar ndihma jonë. Gjithashtu, janë mbështetur edhe shumë artistë për organizimin e ekspozitave të tyre në Galerinë e Arteve në Qendrën e Kulturës, si dhe aktorëve për realizimin e shfaqjeve që janë dhënë në Teatrin e Qytetit ‘Adem Mikullovc’ . Një punëtor i QK “Hasan Prishtina” mban në vazhdimësi të hapur dhe përkujdeset për Kalanë e Qytetit.

Ndër aktivitetet kulturore që kemi organizuar apo që kemi marrë pjesë veçojmë:

Organizimi i ceremonisë së inaugurimit të objektit të Qendrës së Kulturës ‘Hasan Prishtina’, Organizimi i Akademisë për nder të Ditës së Pavarësisë më datë 17 shkurt 2021

Organizimi i një programi për nder të fëmijëve me Sindrom Doën, 21 mars 2021, në Qendrën e Kulturës.

Pjesëmarrja në Festivalin ‘Flakadani i Karadakut’ me 26 mars 2021 në të cilin vendi i parë iu ka nda AKV ‘Hasan Prishtina’.

Organizimi i Akademisë ‘Pranvera Shqiptare’, që i kushtohet demonstratave të vitit 1981, në rastin e 40-vjetorit, më datë 03.04.2021.

Organizimi i Ditës së Çlirimit të Vushtrrisë, më 17 qershor 2021.

Ndër aktivitetet e veçanta që vlen të theksohet është edhe organizimi i Festivalit “Takimet e Poeteshave Shqiptare”, edicioni i 39-të, për të cilin kanë filluar parapërgatitjet rreth organizimit; janë mbledhur poezitë, është caktuar juria dhe është në fazën e vlerësimeve të poezive dhe në ditë në vazhdim presim caktimin e datës së mbajtjes së festivalit.

Biblioteka “Naim Frashëri”

1. Në sektorin për fëmijë janë dhënë për lexim 703 libra,
2. Në sektorin për të rritur janë dhënë për lexim 402 libra,
3. Sallën e leximit e kanë shfrytëzuar 287 lexues,
4. Janë përpunuar 192 libra, dhe
5. Lexues të regjistruar 140 vetë.

Kështu që në dy sektorët e bibliotekës, janë dhënë për lexim 1105 libra.

Në sektorin për fëmijë libri më i lexuar ishte: **“Përtej largësive”** i autorit Bilall Xhaferi.

Në sektorin për të rritur, libri shkollor më i lexuar ishte: **“Gjenerali i ushtrisë së vdekur”** i Ismail Kadaresë.

Libri shkencor më i lexuar ishte **“Financa publike”** i autorit Harvey S. Rosen.

Gjatë periudhës janar – qershor 2021, në bibliotekë janë pranuar 414 libra (libra të dhuruar)

Gjatë këtij gjashtëmuajori, nga Shërbimi Sprovues i Kosovës janë dërguar në bibliotekë për punë në dobi të përgjithshme (të dënuar delikuent – fëmijë) 2 persona.

Sektori për kulturë

Gjatë muajit mars ishte në punëtorinë e organizuar nga UN-Habitat bashkë me Komunën e Vushtrrisë. Punëtorja kishte të bënte me përcaktimin e Zonës Historike. Në muajt mars, prill dhe maj ishte punuar për draft-planin për zonën historike. Ka pasur edhe dy dëgjime publike me qytetarët. Përveç me zonën historike, është marrë edhe me identifikimin e lokaliteteve arkeologjike ku bashkë me ne ishte edhe zyrtar nga IAK(arkeolog) i cili na ndihmoi që të identifikojmë disa lokalitete arkeologjike. Këto lokalitete janë futur në hartë të cilën e ka punuar UN-Habitat.

Gjatë muajit prill, ishin në trajnim për GIS, të cilën e organizoj UN-Habitat. U mbajtën 6 ditë trajnime. Po gjatë këtij muaji (prill), kishin parandaluar një ekspeditë nga Beogradi të cilët patën ardhur në Vushtri për të xhiruar objektet e trashëgimisë kulturore, për t’i përdorur në dokumentarin - filmin për "trashëgimin serbe" në Kosovë. Ata janë ndalur nga policia për disa orë derisa është bërë identifikimi i tyre.

Gjatë muajit maj, kemi pasur në vizitë një delegacion të KFOR-it, i prirë nga komandanti i KFOR-it, në Kosovë. Vizita e tyre në Vushtri kishte të bënte me monumentet e trashëgimisë

kulturore. Kanë qenë edhe dy vizita të tjera pasuese në javët në vazhdim nga ekspedita të KFOR-it po për të njëjtën gjë, vizitë monumenteve të trashëgimisë kulturore. Gjatë muajit maj-qershor janë subvencionuar mbi 30 OJQ.

Muzeu

Gjatë vitit 2021 muzeu u pasurua me 18 eksponate, 16 fotografi, 3 video dokumentar të realizuar në komunën e Vushtrrisë:

- Pamje të rralla të jetesës shqiptare në Kosovë gjatë vitit 1965;
- Video-dokumentar të realizuar në Komunën e Vushtrrisë gjatë vitit 1978 nga Radio Televizioni i Kosovës;
- “Pajtimet e Gjaqeve, falja e gjakut në vitin 1990 në fshatin Strofc, Komuna e Vushtrrisë, realizuar nga Radio Televizioni i Kosovës.

Gjithashtu u inventarizuan dhe u regjistruan dy këngë lirike nga kultura shpirtërore të vjelura nga terreni.

Spektori i Rinisë

Takime pune dhe informuese me përfaqësuesit e OJQ- ve rinore. Gjatë këtyre takimeve është bërë planifikimi dhe janë hartuar projekt propozime dha janë derguar për mbështetje në MKRS dhe USAID-ATRC, OSCE dhe organizata tjera.

Takime pune dhe bashkupim me OSCE.

Qendra Rinore “Hareja” ka mbajtur trajnime për Rrobaqepësi dhe Modë për gra dhe vajza të grup moshave të ndryshme. Në fund të këtyre trajnimeve, pjesëmarrësve u janë ndarë certifikata. Ky projekt është mbështetur nga IOM dhe është asistuar nga sektori i rinisë.

Janë mbajtur takime me kryetaren e KVRL-së. Në këto takime u planifikua projektet që parasheh të organizoj KVRL, po ashtu u diskutua për sfidat dhe problemet që ka KVRL.

Organizata Rinore “Aces” në bashkupim me sektorin e rinisë dhe Departamentin e Rinisë – MKRS ka planifikuar që të organizojn trajnime për të rinjët në komunën e Vushtrrisë. Është hartuar projekt propozimi dhe do të dërgohet për financim.

Takime pune me përfaqësuesit e The Poëer of Mind dhe KVRL-së. Ata kan hartuar një projekt për hartimin e Planit të Veprimt Rinor Lokal. Në fund të këtij projekti do të hartohet PVRL për tri vitet e ardhëshme.

Takim me përfaqësuesin e OJQ “Levizja Koha” me të u diskutua për projektet që parashikon të realizoj kjo OJQ, për formën e aplikimit dhe qasje ne fonde te donator të ndryshëm.

KVRL në bashkupim me organizaten “Domain for Kosovo” kan mbajtur sesion informues për të rinjët në shkollat e mesme, ky sesion ka për qëllim informimin e të rinjëve për themelimin dhe punën e KVRL-së si dhe promovimin e Domenit shtetëror për Kosovë.

Inspekcioni

Aktivitetet të paraqitur në mënyrë tabelare

Inspektorati	Procesverbale	Fletparaqitje	Aktivendime/Urthëresaa	Mbyllje të lokaleve përkohsishtë	Gjoha mandatore
Inspektorët e Tregut - 4	218	-	46	6	5
Inspektori Sanitar - 1	62	-	2660	-	2
Inspektorët e Ndërtimt - 3	44	3	12		2
Inspekt. e Komunikac. - 2	37	-	16		-
Inspektorja e Higjienës - 1	15	-	71	-	1
Totali	376	3	2805	6	10

SUBJEKTE AFARISTE TE PAJISURA ME PËLQIM MBI PLOTËSIMIN KUSHTEVE MINIMALE TEKNIKE – SANITARE

Komisioni - Inspektorati i Tregut dhe Sanitar

APLIKUAR	33
TË VENDOSURA	27
NË PROCEDURË	6
Mjete të inkasuara	1635.00 €

Pranimi teknik i automjeteve

Komisioni - Inspektorët e Komunikacionit

APLIKUAR	16
TË VENDOSURA	16
NË PROCEDURË	-
Mjete të inkasuara në €	80,00 €

PËLQIME SANITARE

Inspektori Sanitar

APLIKUAR	14
TË VENDOSURA	13
Refuzara	-
NË PROCEDURË	1
Mjete të inkasuara	3,849.33 €

Malli i larguar nag shitja dhe qarkullimi dhe mall i asgjësuar nga Inspektorati i Tregut dhe Sanitar.

Mall i asgjësuar	8660,00 kg
------------------	------------

Mjete të inkasuara nga malli i asgjësuar

Mall i asgjësuar	1	150.00 €
------------------	---	----------

Gjopa të aplikuara nga Inspektorati

APLIKUAR	10
TË VENDOSURA	10
Mjete të inkasuara në €	4400,00 €

AKTIVITETET NË FORMË TABELARE

Nr.	PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT	SASIA	VLERA
1	AKTIVITETE INSPEKTUESE	652	
2	PROCES VERBALE	376	

3	AKTVENDIME/ URDHËRESA TË NDRYSHME	2805	
4	FLETËPARAQITJE NË GJYKATË	3	
5	PRANIME TEKNIKE	27	1635.00 €
6	PËLQIME SANITARE	13	3849.33 €
7	PRANIME TEKNIKE TË AUTOMJETEVE	16	80.00€
8	MOSTRA TË USHQIMIT TË MARRURA	-	
9	MALL I LARGUAR NGA SHITJA DHE ASGJASIMI I MALLIT	8660 kg	
10	PAGESË PËR ASGJASIM TË MALLRAVE	1	150.00€
11	KËRKESA TË PRANUARA	265	
12	KËRKESA TË MIRATUARA	255	
13	KËRKESA TË REFUZUARA	3	
14	KËRKESA NË PROCEDURË	7	

15	DENIME MANDATORE	10	4400.00 €
16	MBYLLJE TË PËRKOHSHME TË LOKALEVE AFARISTE	6	

Gjeodezi Kadastër dhe Pronë

Në periudhën Janar-qershor 2021 janë pranuar 651 kërkesa për regjistrimin e bartjes së pronës. Pas zhvillimit të procedurës administrative dhe studimit të lëndëve ky shërbim ka marr 626 aktvendime me të cilat janë miratuar kërkesat e palëve, kurse në procedurë administrative për vendosje janë edhe 25 kërkesa (lëndë).

Kemi pranuar nga ana e palëve – qytetarëve 72 kërkesa për korigjimin e gabimeve sa i përket emrit apo mbiemrit në regjistrat e pronave, të cilat gabime kanë pasuar nga e kaluara. Pas zhvillimit të procedurës administrative janë aprovuar 61 kërkesa të tilla ndërsa 11 prej tyre janë refuzuar. Këto kërkesa në lidhje me korigjimin e emrit apo të mbiemrit bëhen pa pagesë.

Janë pranuar gjithashtu 62 kërkesa për regjistrimin e hipotekave dhe 30 kërkesa për çregjistrimin e hipotekave, të paraqitura nga personat fizik dhe juridik. Pas zhvillimit të procedurës kemi marr 62 aktvendime për regjistrimin e hipotekave dhe 30 aktvendime për çregjistrimin e hipotekave.

Për nevoja të aplikuasve të ndihmës sociale janë lëshuar 150 certifikata që nuk posedojnë pasuri të paluajtshme si dhe 120 certifikata pronësore. Pasi që përfituesit e ndihmës sociale janë të liruar nga pagesa për shërbimet të tilla nga këto shërbime nuk janë inkasuar mjete financiare.

Janë lëshuar 1190 certifikata pronësore dhe 380 kopje të planit.

Janë zhvilluar procedurë të shpronësimit të pronës së paluajtshme për interes publik në Vushtri, rrua 2 Maji (dy prona të paluajtshme).

Gjithsejtë të hyrat buxhetore nga Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë janë 50888.62 euro, ndërsa të hyra nga dhënia me qira të pronave komunale janë inkasuar 2155.00 euro, keto janë borxhe paraprake pasi që me Vendim të Kuvendit edhe për këtë vit janë të liruar nga pagesa e qirasë.

Pranë kësaj drejtorie gjatë kësaj periudhe kemi aprovuar kërkesa zyrtare të ndryshme të parashtruara nga ana e organeve komunale, gjyqësore, institucioneve qeveritare dhe joqeveritare etj.

Mbrojtje dhe Shpëtim

Gjatë periudhës janar-qershor 2021, në DMSH ka pasur angazhime të rregullta por edhe raste emergjente veçanërisht me rastet e vërshimeve ku edhe kemi intervenuar me kompaninë e kontraktuar për situata emergjente në terren për eliminimin e disa pikave kritike .

Janë mbajtur takime me pjesëtarë të FSK-së, AME-së me Policinë e Kosovës - Stacioni në Vushtrri, KFOR-in , Kryqin e Kuq në Vushtrri, QOR 112, etj.

Në muajin janar jemi përballë me vërshime të mëdha ku është goditë qyteti i Vushtrrisë dhe fshatrat përgjatë lumit Silnica të cilën situatë e kemi menagjuar me angazhim maksimal.

Komisionet Komunale kanë bërë vlerësimin e dëmeve ku janë hartuar raporte të detajuara të cilat iu janë dërguar ministrive përkatëse për kompensim të dëmeve pasi që komuna nuk ka buxhet për kompensim të këtyre dëmeve.

Kemi përcjellë poashtu situatën nëpër vendmihjet ku është nxjerrë thëngjill në fshatin Bivolak, Strocë dhe Zhilivodë ku gjendja në këto fshatra (në gropat ku është nxjerrë thëngjilli) nuk është e mirë dhe ende mbetet shqetësuese për arsye se paraqesin rrezik për jetën e qytetarëve dhe shtazëve.

Në Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim gjatë kësaj periudhe 6 mujore kemi pranuar dhe shqyrtuar 310 lëndë të ndryshme. Të gjitha këto lëndë janë shqyrtuar dhe miratuar.

Përfundim,

Ky raport paraqet punët që janë kryer nga ekzekutivi i komunës në këtë gjashtëmujor. Nga muaji qershor deri në ditën kur po paraqitet ky raport janë kryer edhe punë dhe projekte tjera të shumta të cilat do të përfshihen në raportin vjetor 2021.

Xhafer Tahiri



Kryetar i Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA VUSHTRRI

DATË/A:	14.09.2020
PËR/ZA/TO:	Kuvendin e Komunës
PËRMES	Xhafer Tahiri, Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	Abit Abiti, ZKF
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport

Komuna e Vushtrrise e ka pranuar Raportin e Auditimit për pasqyrat vjetore të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2020, dhe në pajtim me Procedurat Standarde të Operimit, Trajtimi i të Gjeturave dhe Zbatimi i Rekomandimeve të Auditorit të Jashtëm dhe të Brendshëm nga SSP e Audituar, prandaj këtë raport si dhe planin e veprimit lidhur me të gjeturat e Zyrës Kombëtare të Auditimit po e prezantojmë në Kuvendin Komunal.

Me respekt!

Shtojcë raportet:



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË VUSHTRRIË PËR VITIN 2020

Prishtinë, korrik 2021

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Shënim

Ky Raport i auditimit është gjeneruar për herë të parë përmes platformës elektronike për menaxhimin e auditimit (SITA). Po ashtu, këtë vit, përdoret shablloni i ri i Raportit të auditimit, sipas metodologjisë së përditësuar për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë. Raporti përfshinë për herë të parë edhe konkluzionin e veçantë për pajtueshmëri.

Jemi plotësisht të vetëdijshëm që aplikimi i të gjitha këtyre risive njëkohësisht, në rrethana të pazakonshme të pandemisë, mund të rezultojë me ndonjë lëshim të paqëllimshëm teknik, për çka ju kërkohet falje paraprakisht dhe ju falënderojmë për mirëkuptim!

Për: Xhafer Tahiri, Kryetar i Komunës së Vushtrrisë

Adresa: Rruga "Isa Boletini" nr.10 Vushtrri, Kosovë, Vushtrri, Republika e Kosovës

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Vushtrrisë për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Vushtrrisë (VU), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Vushtrrisë, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar gjithashtu pajtueshmërinë e menaxhmentit të Komunës së Vushtrrisë me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të VU kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në

kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Theksimi i Çështjes

- 1 Për vëmendjen tuaj, dëshirojmë të theksojmë faktin se si rezultat i buxhetimit të gabuar, Komuna kishte bërë pagesa në shumë prej 260,198€ nga kategoritë jo adekuate, prej të cilave nga Investimet kapitale: 83,208€ ishin paguar për Subvencione e transfere. Si rezultat, për të njëjten shumë ishte mbivlerësuar kategoria e Investimeve kapitale dhe nënvlerësuar kategoria e Subvencioneve e transfereve; dhe 71,750€ ishin paguar për Mallra e shërbime, me ç'rast ishte mbivlerësuar kategoria e Investimeve kapitale dhe nënvlerësuar kategoria e Mallrave dhe shërbimeve; Ndërsa 105,240€ për Subvencione e transfere (për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për qytetarët) ishin paguar nga Mallrat dhe shërbimet, duke rezultuar me mbivlerësim të Mallrave dhe shërbimeve dhe nënvlerësim të Subvencioneve dhe transfereve për të njëjten shumë.

Përveç kësaj, Komuna kishte bërë edhe pagesa tjera në bazë të vendimeve gjyqësore në shumë prej 1,410,488€ për kompensimin e pagave jubilarë, pagave përcjellëse, shujtave dhe shpenzimet tjera të procedurave gjyqësore, përkatësisht 717,648€ janë paguar nga Mallrat dhe shërbimet dhe 692,840€ nga Investimet kapitale. Rrjedhimisht, për të njëjtat shuma, ishin mbivlerësuar kategoria e Mallrave e shërbimeve dhe Investimeve kapitale dhe nënvlerësuar kategoria e Pagave dhe mëditjeve.

Kjo kishte ndodhur për arsyen se: 1. me rastin e aprovimit të Ligjit për ndarjet buxhetore të vitit 2020, këto shpenzime ishin planifikuar dhe ekzekutuar në kategori jo adekuate ekonomike; dhe 2. për shkak të mungesës së fondeve buxhetore, të cilat me rastin e ndarjeve buxhetore nga Qeveria, përkatësisht Ministria e Financave, detyrimet për paga në bazë të vendimeve gjyqësore nuk ishin marrë parasysh si detyrime rrjedhëse gjatë vitit dhe rrjedhimisht, nuk ishte ndarë asnjë fond kontigjent për kompensimin e tyre. Thesari kishte ekzekutuar pagesat nga fondet e ndara për kategoritë tjera. Duke qenë se çështjet në fjalë janë mjaft të përhapura në shumë organizata buxhetore dhe po përsëriten për vite me radhë, ato do të trajtohen më hollësisht në Raportin e auditimit të Pasqyrave Financiare të

Qeverisë, ku edhe do të jepen rekomandimet përkatëse për zgjidhje afatgjatë.

Opinionin e auditimit nuk është modifikuar për shkak të kësaj çështje.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundur përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Vushtrrisë.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Vushtrrisë është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Vushtrrisë në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Vushtrrisë me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Vushtrrisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.


Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve (shih Grafikonin 1). Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i shqyrtojmë këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Grafiku 1. Lloji i gjetjeve sipas kategorive ekonomike⁴



Ne po ashtu, kemi rishikuar statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre. [Për detajet shih kapitullin 4].

2.1 Gjetjet për çështjet e menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna e Vushtrrisë në 2020 ishin 2,116,618€, pothuajse në një shumë të njëjtë me atë të vitit paraprak. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga taksa për grumbullimin e mbeturinave, të hyrat nga qiraja etj. Komuna kishte edhe të hyra të arkëtuara nga institucionet tjera në emër të komunës, si në vijim: gjobat në trafik 198,861€, dhe gjobat nga gjykatat 11,725€. Për qëllime ekzaminimi, ne kemi shqyrtuar 14 mostra për teste substanciale në vlerë 17,289€.

Çështja A1 - Vonesa në deponimin e parasë së gatshme në llogarinë bankare

Gjetja

Neni 11 i Rregullës Financiare 03/2010 për të hyrat përcakton që paratë e grumbulluara nga Organizatat Buxhetore (OB) nga arkëtimet për shërbime në lartësi deri 10€, duhet në fund të ditës të depozitohen në llogarinë bankare.

Në dy raste kemi evidentuar se paratë e arkëtuara nga ekstraktet e lindjes dhe participimi në QKMF nuk ishin depozituar me kohë, në arkën kryesore rrjedhimisht në bankë, vonesat ishin nga pesë (5) ditë deri afërsisht dy (2) muaj, ndonëse vlerat monetare nuk ishin materiale. Përkatësisht:

- Të hyrat e arkëtuara nga participimet në QKMF, nga data 10.11.2020-17.11.2020, në vlerë 607€, janë depozituar në bankë me datë 17.11.2020;
- Të hyrat e arkëtuara nga ekstraktet e lindjes, nga data 13.03.2020-06.05.2020, në vlerë 83€, janë depozituar në bankë me datë 06.05.2020.

Kjo ka ndodhur si shkak i kontrolleve të brendshme jo efikase përkatësisht rrethanave të krijuara si rezultat i pandemisë dhe vështirësive në organizimin e stafit.

Ndikimi

Parregullsitë e tilla mund të rrisin rrezikun e humbjes apo edhe keq përdorimit të parasë së gatshme.

Rekomandimi A1

Kryetari të sigurojë përmirësimin e kontrolleve të brendshme në mënyrë që paratë e gatshme të grumbulluara në arkë të dorëzohen

dhe të depozitohen në bankë sipas kërkesave të rregullës financiare për të hyrat.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Regjistrimi i të hyrave në kode ekonomike jo përkatëse

Gjetja Me rregullat e Thesarit dhe Udhëzimin administrativ NR. 19/2009 për planin kontabël të SIMFK-së janë përcaktuar kategoritë dhe kodet ekonomike sipas llojit për regjistrim.

Nga testimi i të hyrave të arkëtuara në vlerë 8,560€ për leje mjedisore komunale, kemi identifikuar se ishin klasifikuar gabimisht në kodin ekonomik të lejeve ndërtimore. Rrjedhimisht kemi evidentuar se të gjitha arkëtimet për leje mjedisore komunale në vlerë të përgjithshme prej 38,912€, arkëtimet nga lejet për legalizim në vlerë 15,036€ si dhe nga lejet për rrënimë në vlerë 3,328€, nuk ishin klasifikuar në kodet adekuate ekonomike sipas planit kontabël por ishin regjistruar të gjitha në kodin e lejeve ndërtimore.

Kjo ka ndodhur si shkak i moskujdesit të duhur në përdorimin e kodeve adekuate ekonomike si dhe praktikave të zbatuara deri më tani.

Ndikimi Regjistrimi i të hyrave në kode ekonomike jo adekuate ndikon negativisht në prezantimin e drejtë të të hyrave në pasqyrat financiare, si dhe në informimin jo të drejtë për vendimmarrësit dhe shfrytëzuesit e informatave financiare.

Rekomandimi A2 Kryetari të sigurojë përmirësimin e kontrolleve të brendshme në këtë fushë në mënyrë që të hyrat të klasifikohen drejtë në përputhje me kodet përkatëse ekonomike të përcaktuara me planin kontabël të Thesarit/SIMFK.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Dobësi në procesin e veprimtarive inspektuese të objekteve brenda territorit të Komunës

Gjetja Sipas nenit 15.2 të Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, veprimtaritë inspektuese kryhen çdo vit për të paktën njëzetë përqind (20%) të të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës.

Komuna në vitin 2020 nuk ka arritur të plotësoj këtë kriter të kryerjes së veprimtarive inspektuese, ngase nga totali 22,480 objekteve të regjistruara janë verifikuar 3,377 objekte apo rreth 15%.

Kjo ka ndodhur si shkak i dobësive në organizimin e veprimtarive

inspektuese ndër të tjera edhe si rezultat i ndikimit të pandemisë dhe vështirësive në organizimin e stafit.

Ndikimi Mos verifikimi i objekteve mund të rezultojë me mangësi të informacionit aktual rreth data bazës së tatimit në pronë dhe mund të ndikojë negativisht në vlerësimin e tatimit në pronë.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të siguroj mekanizma efektiv për inspektimin e kuotës së përcaktuar prej 20% të objekteve siç kërkohet me ligjin e ri si dhe të rrisë kontrollin e menaxhimit të punëve në teren.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C1 - Dobësi në menaxhimin e të dhënave të tatimit në pronë

Gjetja Neni 11 i Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, përcakton se njësia e objektit që shërben si vendbanim parësor për personat fizik, i lejohet zbritja prej 15,000€ nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit.

Në një rast kemi identifikuar se zbritja prej 15,000€ ishte aplikuar në dy njësi të banimit të një tatimpaguesi fizik.

Kjo ka ndodhur si shkak i kontrolleve të dobëta në këtë fushë lidhur me përditësimin e informacionit të tatimpaguesve në sistem.

Ndikimi Dobësitë e identifikuar lidhur me aplikimin e zbritjeve në më shumë se një njësi të objektit, respektivisht mos përditësimi i informatave të tatimpaguesve, ndikon në nënvlerësimin e bazës tatimore dhe rrjedhimisht në performancën buxhetore.

Rekomandimi C1 Kryetari duhet të sigurojë kontrolle shtesë në departamentin e tatimit në pronë, në mënyrë që të dhënat në sistemin ProTax të jenë të harmonizuara me rregulloren e tatimit në pronën e paluajtshme të Komunës dhe me ligjin, dhe të gjitha rastet e tilla të korrigjohen.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.2 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe komunalitë në vitin 2020 ishte 4,699,861€, prej të cilave ishin shpenzuar 3,392,939€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shërbime kontraktuese, shërbime komunale, furnizime të ndryshme për zyre, mirëmbajtjen e objekteve dhe pajisjeve etj. Për qëllime të auditimit, kemi testuar 28 mostra për teste substanciale në vlerë 945,494€ si dhe pesë (5) mostra për teste (procedura) të pajtueshmërisë.

Çështja A3 - Dobësi në përmbushjen e kriterit të dosjes së tenderit lidhur me vërtetimin tatimor

Gjetja

Në dy aktivitete të prokurimit, kemi identifikuar se nuk ishte respektuar kriteri i përcaktuar në dosjen e tenderit/njoftimin për kontratë, respektivisht të kërkesat e përshtatshmërisë, ku ishte kërkuar “Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e vendit Tuaj të themelimit se Ju nuk jeni në vonesë për pagimin e tatimeve, ky vërtetim duhet të jetë jo më i vjetër se 90 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të tenderit, duhet të dorëzohet nga Operatori Ekonomik të cilit synohet dhënia e kontratës”.

Mangësitë e identifikuara janë gjetur në këto dy aktivitete të prokurimit:

- Te aktiviteti i prokurimit “Furnizim me material shpenzues për laborator (reagensa)”, në vlerë 95,515€, kemi identifikuar se vërtetimi tatimor ishte prezantuar me validitet të skaduar përtej afatit 90 ditor nga data e dorëzimit të tenderëve;
- Te aktiviteti i prokurimit “Furnizim me material higjenik dhe mbrojtës për nevoja të personelit të administratës komunale pas situatës së krijuar si pasojë e përhapjes së sëmundjes infektive Corona Virus Covid 19 ”, në vlerë 27,331€, kemi identifikuar se vërtetimi tatimor ishte prezantuar me borxhe tatimore apo obligime tjera tatimore të pashlyera.

Kjo ka ndodhur si rezultat i kontrolleve të brendshme jo efikase në procesin vlerësimit të tenderëve konform kriterëve të përcaktuara në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë.

Ndikimi

Mangësitë e identifikuara rreth mos plotësimit të kërkesave të përshtatshmërisë në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë, lidhur me vërtetimin tatimor mund të reflektojnë negativisht në përzgjedhjen e operatorit të përgjegjshëm ekonomik dhe në përmbushjen e drejtë të kontratës konform kushteve kontraktuale.

Rekomandimi A3 Kryetari të sigurojë përmirësimin e kontrolleve të brendshme në procesin e vlerësimit dhe përzgjedhjes së tenderëve konform kritereve të përcaktuara në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A4 - Dobësi në menaxhimin e aktiviteteve të prokurimit dhe kontratave

Gjetja Neni 62 i Rregullave dhe udhëzuesit operativ për prokurimin publik (RrUOPP), për ndarje të detyrave, ndër të tjera përcakton se “Një anëtar i komisionit të vlerësimit nuk mund të emërohet si Menaxher i projektit” gjithashtu “Një zyrtar nga një departament i cili ka përgatitur specifikimet dhe/ose termat e references, ose ka përcaktuar standardet e cilësisë, ose vizatimet e përgatitura nuk mund të marrë pjesë si një anëtar i komisionit të vlerësimit”.

Në dy procese të zhvillimit të aktiviteteve të prokurimit dhe kontratave kemi identifikuar mangësitë në vijim:

- Te aktiviteti i prokurimit “Furnizim me pako ushqimore dhe higjienike për ndihmë familjeve në nevojë pas situatës së krijuar si pasojë e përhapjes së sëmundjes infektive Corona Virus, Covid 19”, në vlerë 49,600€, kryesuesi i komisionit të vlerësimit të tenderëve ishte caktuar po ashtu edhe si menaxher i kontratës;
- Te aktiviteti i prokurimit “Mirëmbajtja e ndriçimit publik në qytet dhe fshatra, për nevoja të A.K. – Vushtrri”, me çmim të peshuar në vlerë 105€, personi i cili ka përgatitur paramasën dhe paralogarinë ishte caktuar edhe kryesues i komisionit të vlerësimit të tenderëve.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mos disponueshmërisë së stafit të mjaftueshëm për ndarje të drejtë të detyrave në procesin e zhvillimit të aktiviteteve të prokurimit.

Ndikimi Caktimi i personave të njëjtë në disa procese në menaxhimin e aktiviteteve të prokurimit dhe kontratave reflekton negativisht në ndarjen e drejtë të detyrave.

Rekomandimi A4 Kryetari të sigurojë ndarjen e drejtë të detyrave në procesin e menaxhimit të aktiviteteve të prokurimit dhe kontratave konform respektimit të kritereve ligjore dhe rregullave të prokurimit publik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.3 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 764,226€, dhe prej tyre në 2020 ishin shpenzuar 689,149€. Ato janë dhënë për entitete publike dhe jopublike dhe kanë të bëjnë kryesisht me përkrahjen e sektorit të bujqësisë, kulturës, sportit dhe aktiviteteve tjera në kuadër të komunës. Në këtë fushë kemi testuar pesë (5) mostra për teste substanciale në vlerë 115,947€ si dhe pesë (5) mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja C2 - Dobësi në menaxhimin e subvencioneve

Gjetja Për tu kualifikuar për mbështetje financiare publike aplikuesi duhet ti plotësoj kriteret e përgjithshme të përcaktuara me rregullore dhe thirrje publike.

Nga testimi i thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, kemi identifikuar një rast në të cilin dokumentacioni i kërkuar ishte dorëzuar pas afatit të përcaktuar me thirrje publike. Vendimi për caktimin e përfituesit ishte nxjerrë me dt. 11.12.2020, ndërsa dokumentet të cilat nuk ishin dorëzuar me kohë janë:

1. Aplikacioni me dt. 12.12.2020;
2. Deklarata mbi financimin e dyfishtë me dt. 12.12.2020; si dhe
3. Çertifikata nga evidenca e personave kundër të cilëve është duke u zhvilluar procedura penale dhe personave të dënuar nga gjykata me dt. 14.12.2020.

Kjo gjendje ishte si pasojë e mungesës së kontrolleve dhe pakujdesisë së komisionit të themeluar për vlerësimin e aplikacioneve.

Ndikimi Mungesa e dokumenteve për përmbushjen kritereve në procesin e vlerësimit të aplikantëve, mund të eliminojë padrejtësisht përfituesit të cilët përmbushin kriteret e caktuara me rregullore/thirrje publike, dhe të dëmtoj kredibilitetin e procesit.

Rekomandimi C2 Kryetari duhet të sigurojë që procesi i vlerësimit të aplikuesve të dokumentohet me dëshmi përkatëse duke siguruar në të njëjtën kohë të mos shkelet parimi i konkurrencës, si dhe përfitues të subvencioneve të jenë vetëm aplikuesit që përmbushin kriteret e përcaktuara në thirrjen publike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.4 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 6,066,371€, prej tyre në 2020 ishin shpenzuar 4,320,959€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me ndërtim dhe rregullim të infrastrukturës rrugore, ujësjellësit dhe kanalizimeve, ndërtim të shkollave dhe parqeve, shpronësime, blerje të pajisje dhe përmirësime të ndryshme të kapitalit. Kemi testuar 42 mostra për teste substanciale në vlerë 1,672,448€, si dhe pesë (5) mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja B2 - Vonesa në realizimin e kontratave

Gjetja Kontratat përcaktojnë afatet për realizimin e tyre. Në tre kontrata të testuara, kemi evidentuar se është dashur të përfundonin në vitin 2019/2020.

Nga pagesat e testuara kemi evidentuar vonesa në realizimin e tre (3) kontratave të cilat është dashur të përfundonin në vitin 2019/2020, mirëpo ende nuk ishin përmbyllur as gjatë kohës që ne ishim në ekzekutim të auditimit (mars 2021). Vonesat kanë të bëjnë me projektet: (1) "Ndërtimi i QMF-së në Vushtrri" projekt dy vjeçar prej 346,222€; (2) "Asfaltimi i rrugës Vushtrri-Nadakofc-Pestovë faza e parë" prej 282,347€, dhe (3) "Ndërtimi i sheshit Ahmet Krasniqi në qytetin e Vushtrrisë" prej 93,664€.

Duhet theksuar se në asnjërin prej këtyre rasteve nuk kishte kërkesë/aprovim për zgjatjen e afatit për realizimin e kontratave, siç përcaktohet në nenin 18 të dosjes standarde të tenderit. Po ashtu, nuk kishte aplikim të penaleve.

Shkaqet e vonesave kryesisht ishin për shkak të menaxhimit jo adekuat të komunës lidhur me problemet pronësore, specifike të punëve, pa përgjegjshmërisë së OE, kushteve atmosferike etj. Ndërsa, mos formalizimi i vonesave ishte për shkak të mungesës së njohurive të menaxherëve të kontratave lidhur me kërkesat ligjore.

Ndikimi Vonesat në kryerjen e projekteve ndikojnë në rritjen e obligimeve kontraktuese të cilat më vonë mund të bëhen barrë për buxhetin e vitit pasues. Kjo, po ashtu, ndikon në performancën dhe mos arritjen e objektivave të përcaktuara të Komunës.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë që mos të fillohen projektet pa u siguruar për çështjet e problemeve pronësore, hartimit të specifikeve adekuate të projekteve dhe se menaxherët e kontratave formalizojnë procesin e shtyrjes së afateve kur ato janë të nevojshme nga ana e Komunës. Po ashtu, për vonesat e pa arsytuar, të aplikohen penalet e parapara me kontratë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja B3 - Mungesa e projektit ekzekutues**

Gjetja Neni 20.10 i RrUOPP kërkon që specifikat teknike për kontratën e punës, duhet të përfshijnë një projekt ekzekutues si pjesë substanciale të veten.

Ne kemi identifikuar se në pesë (5) kontrata pune komuna nuk kishte hartuar projektin ekzekutues, por i kishte zhvilluar procedurat e prokurimit duke përgatitur vetëm paramasën dhe parallogarinë. Mungesa e projekteve ekzekutuese kryesisht ishte te renovimet dhe ndërtimi i rrugëve.

Mungesa e projekteve sipas vlerësimeve të zyrtarëve përgjegjës ishte për shkak të thjeshtësisë së punëve të cilat ishte paraparë për tu kryer.

Ndikimi

Mungesa e projekteve ekzekutuese dhe inicimi i procedurave për projekte kapitale vetëm me paramasë dhe parallogari, rritë rrezikun që gjatë procesit të ekzekutimit të projekteve të paraqiten pengesa të ndryshme si në aspektin profesional, ashtu edhe në vonesat e punimeve apo edhe në rritjen e kostove të projekteve.

Rekomandimi B3

Kryetari duhet të sigurojë se për të gjitha aktivitetet e prokurimit që kanë të bëjnë me punë, të mos iniciohen procedurat pa u siguruar specifika të qarta sipas projektit ekzekutues të cilat do të ndikonin në eliminimin e vonesave dhe të kostove shtesë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja B4 - Mangësi në ekzekutimin/menaxhimin e kontratave****Gjetja**

Rregulla financiare Nr. 01/2013 për shpenzimin e parasë publike, nenet 22 deri 26, ndër të tjera përcaktojnë se paraprakisht duhet të bëhet pranimi i mallrave/punëve pastaj duhet të bëhet pagesa. Neni 61.21 i RrUOPP specifikon se “Ndryshimi i kontratës i referohet një ndryshimi në termat dhe kushtet e një kontrate të shpërblyer”, neni 61.22 thotë se “ndryshimi i kontratës do të përgatitet nga departamenti i prokurimit”, ndërsa neni 61.23 thotë se kjo mund të bëhet “vetëm pas marrjes së aprovimit nga Zyrtarit Kryesor Administrativ”.

Në tre (3) kontrata kemi evidentuar mangësi në ekzekutimin/menaxhimin e kontratave si në vijim:

- Te kontrata "Ndërtimi i fushës ndihmëse të stadiumit të futbollit" prej 118,527€, kemi evidentuar se te pjesa për

ndërtimin e zhveshtoreve, pozicioni 15 ishte paguar në tërësi sasia e kontraktuar, ndërsa nuk ishte bërë muratimi i komplet mureve të brendshme. Ndërsa te pozicioni 21 që kishte të bënte me Furnizimin dhe vendosjen e tjegullave (kulmi), ishte ndryshuar dhe kulmi ishte bërë me llamarinë. Ky ndryshim nuk është evidentuar në situacionin që ishte procesuar për pagesë dhe nuk kishte ndonjë aprovim formal.

- Te kontrata "Ndërtimi i sallës sportive në SHMU-1" prej 260,666€, kemi evidentuar disa pozicione të cilat ishin paguar në tërësi por që nuk ishin kryer punët. Pozicionet që ishin paguar pa u kryer punët kishin të bënin me punët e zdrukthtarisë përkatësisht pozicionet: 13.2, 13.3, 13.7, 13.8, 13.9, 13.10, 13.11, 13.12 dhe 13.3. Vlera totale e këtyre pozicioneve të paguara por që nuk ishin punuar ishte 3,320€.
- Te kontrata "Ndërtimi i objektit për ruajtjen e patates në fshatin Pestovë" prej 157,237€, kemi evidentuar se pozicioni 1.2 i paramasës së kontraktuar (çmimi i kontraktuar është jo normalisht i lartë) ishte paguar në tërësi për pozicionin që pëmbante punë për pastrimin e terrenit në fund të punimeve, ndërsa nuk ishte dashur të paguhet. Nga menaxheri i kontratës jemi njoftuar se objekti nuk është duke u ndërtuar në vendin e paraparë me projekt dhe se mungonin aprovimet formale nga ZKA për ndryshimin e lokacionit për ndërtim.

Të gjitha këto ndryshime në realizimin e kontratave janë bërë pa aprovimet e Zyrtarit Kryesor Administrativ (ZKA) dhe zyrës së prokurimit, siç kërkohet me ligjin dhe rregullat/udhëzuesin për prokurimin publik. Duhet theksuar se menaxherët e kontratave ishin në njohuri për kërkesat ligjore për prokurimin publik lidhur me aprovimet e nevojshme për ndryshimin e kontratave, ngase dukuria e mangësive në menaxhimin e kontratave përsëritet edhe në raportin e auditimit të vitit paraprak.

Ndikimi

Ekzekutimi i punëve në kundërshtim me paramasën dhe parallogarinë e kontraktuar pa aprovimin e ZKA-së dhe zyrës së prokurimit shpërfaq dobësitë në kontrollet e ushtruara nga menaxhmenti i lartë. Kjo mund të ndikojë në cilësinë e punëve të kryera si dhe mund të rezultojë që për shkak të ndryshimit të kushteve të kontratës nuk është përzgjedhur operatori më i lirë. Ndërsa, pagesat për punë të pa kryera mund të rezultojë me dëmtim të buxhetit dhe keqpërdorim të parasë publike.

Rekomandimi B4

Kryetari duhet të siguroj se menaxherët e kontratave dhe çertifikuesi, aplikojnë kontrole efektive në procesin e shpenzimit të parasë publike dhe menaxhimin e kontratave për tu siguruar se pagesat bëhen vetëm sipas çmimeve të kontraktuara dhe punëve/furnizimeve

të realizuara. Po ashtu, për gabimet financiare dhe ndryshimet e identifikuar, komuna duhet të sigurohet se do të bëhet kthimi i mjeteve financiare në buxhetin e komunës dhe realizohen aprovimet e nevojshme për kontratat të cilat ende nuk janë përmbyllur.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.5 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 112,599,101€, pasurive jokapitale është 450,098€, ndërsa vlera stoqeve nuk ishte shpalosur. Kemi testuar 70 mostra për teste substanciale në vlerë 12,943,663€, si dhe kemi kryer teste të pajtueshmërisë lidhur me procedurat e brendshme të menaxhimit të pasurive, inventarizimin dhe vlerësimin e pasurive, funksionimin e sistemit e-pasuria etj.

Çështja B5 - Mangësi në procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive jo financiare

Gjetja Neni 19.4.3 i Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare përcakton se duhet të bëhet krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen e regjistrave të pasurive jo financiare. Ndërsa neni 21 i po kësaj rregulloreje ka përcaktuar kërkesat për vlerësimin e pasurive jo financiare.

Komuna ka kryer procesin e inventarizimit të pasurive jo financiare, mirëpo nuk ishte bërë krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare, siç kërkohet me nenin 19.4.3 të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare. Po ashtu nuk ishte bërë vlerësimi i pasurive jo financiare sipas kërkesave të nenit 21 të kësaj rregulloreje.

Magësitë në procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive, kryesisht ishin për shkak të mungesës së njohurive lidhur me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurive jo financiare si dhe mungesës së udhëzuesve të brendshëm lidhur me procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive.

Ndikimi Mos krahasimi i inventarizimit me gjendjen e regjistrave të pasurive dhe mos vlerësimi i pasurive, nuk jep siguri lidhur me saktësinë dhe plotësinë e regjistrave të pasurisë.

Rekomandimi B5 Kryetari, duhet siguruar se procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive do të kryhet sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja C3 - Mangësi në regjistrin kontabël të pasurive**

Gjetja Neni 6.3 i Rregullores për 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare thotë se: Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin e-pasuria.

Ne kemi evidentuar 23 pagesa të shpenzimeve kapitale dhe jo kapitale prej 201,778€ të cilat nuk ishin regjistruar në regjistrin e pasurive jo financiare (prej tyre tetë (8) pagesa me vlerë 155,266€ nuk janë regjistruar në SIMFK dhe 15 pagesa prej 46,512€ në e-pasuria).

Duhet theksuar se vlera e pasurive jo kapitale e paraqitur në pasqyrat financiare vjetore (PFV) ishte 450,098€. Mirepo, kemi vërejtur se sistemi për regjistrimin dhe menaxhimin e pasurive jo kapitale “e-pasuria” nuk ishte aplikuar gjatë vitit 2020. Si rezultat, nuk mund të japim siguri për vlerën e pasurive jo kapitale të shpalosur në PFV. Po ashtu vlera e stoqeve nuk ishte shpalosur në PFV.

Sipas zyrtarëve komunal, mos regjistrimi i të gjitha pasurive kishte ndodhur për shkak të volumit të madh të punëve në fund të vitit.

Ndikimi Mungesa e regjistrave të saktë dhe të plotë shkakton mungesë të informatave për menaxhmentin lidhur me pasurinë që posedon komuna, shkakton mbi/nënvlerësim të pasurive si dhe mund të rezultojë në prezantimin jo të drejtë të informatave në pasqyra financiare.

Rekomandimi C3 Kryetari, duhet të sigurohet që do të bëhet azhurnimi i regjistrit të pasurive kapitale konform gjetjeve të auditimit të trajtuara me lartë për të siguruar se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive komunale.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.6 Të arkëtueshmet

Komuna në PFV e vitit 2020 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 4,449,650€. Kjo vlerë përbëhet nga të arkëtueshmet e tatimit në pronë, taksa në biznes, taksa për grumbullimin e mbeturinave, shfrytëzimi i pronës publike dhe të tjera. Gjithsej kemi testuar 37 mostra për teste substanciale në vlerë 356,455€.

Çështja B6 - Dobësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme (LLA)

Gjetja Arkëtimi i të hyrave bëhet sipas afateve kohore të përcaktuara në faturë për secilin lloj të të hyrave.

Pjesa më e madhe e LLA i takon tatimit në pronë me rreth 64%, taksat për mbledhjen e mbeturinave rreth 20%, taksa në firmë rreth 11% dhe të tjera. Komuna nuk kishte menaxhim efektiv në mbledhjen e të arkëtueshmeve pasi që vazhdon rritja e tyre vit pas viti. Në krahasim me vitin paraprak rritja ishte rreth 348,454€.

Llogaritë menaxhohen nga sisteme të integruara (tatimi në pronë, taksa në biznes dhe taksat nga mbeturinat), përderisa disa llogari tjera menaxhohen në excel/word.

Rritja e llogarive të arkëtueshme vit pas viti ishte për shkak të mos marrjes së të gjitha veprimeve të mundshme për arkëtimin e tyre. Ndonëse duhet të kihet parasysh edhe ndikimi i pandemisë në nivelin e arkëtimin të tyre.

Ndikimi Mos arkëtimi në kohë i të hyrave të ngarkuara ndikon në nivelin e fondeve të mbledhura për buxhetin komunal me refleksion negativ në financimin dhe realizimin e projekteve nga të hyrat vetjake.

Rekomandimi B6 Kryetari, duhet të sigurojë efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme. Hartimi dhe aplikimi i programeve dhe procedurave të qarta për mënyrën e menaxhimit, regjistrimit dhe arkëtimin të tyre, do të ishin disa nga masat që mund të sjellin përmirësime.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.7 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) kishte drejtorin dhe një anëtar. Përveç planit strategjik, NjAB kishte hartuar edhe planin vjetor të punës ku ishin përfshirë gjashtë (6) auditime, përkatësisht pesë (5) auditime pas rishikimit të planit për shkak të pandemisë të cilat edhe ishin realizuar gjatë vitit 2020. Numri i rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit është 18, prej të cilave të zbatuara ishin dhjetë (10) në proces ishin gjashtë (6) dhe dy (2) të pazbatuara. Auditimet ishin fokusuar në fushën e prokurimit, vlerësimit të sistemit të kontrolleve nëpër drejtori të ndryshme si dhe në fushën e të hyrave, përderisa periudha e mbuluar me auditim ishte kryesisht viti 2020. Komiteti i auditimit ishte funksional dhe kishte mbajtur tre (3) takime, ku ishte diskutuar për raportin e auditorit të jashtëm dhe të NjAB.

Çështja B7 - Mos kompletimi i NjAB

Gjetja Neni 5.1.1 i Rregullores 01/2019 për themelimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm përcakton që çdo subjekti i sektorit publik me buxhet mbi shtatë (7) milion euro duhet të ketë së paku tre auditorë.

NjAB në Komunën e Vushtrrisë përbëhet nga drejtori dhe një anëtar.

Kjo gjendje ishte për shkak mungesës së buxhetit të ndarë për plotësimin e numrit minimal të auditorëve sipas kërkesave ligjore.

Ndikimi Mos kompletimi i NjAB-së me staf të mjaftueshëm, mund të ndikojë që auditimi i brendshëm mos të mbulojë të gjitha fushat me rrezik, dhe t'i pamundësoj menaxhmentit marrjen e veprimeve me kohë për parandalimin e gabimeve të mundshme.

Rekomandimi B7 Kryetari, duhet të sigurojë se për pozitat e kërkuara do të bëhen planifikimet buxhetore me kohë dhe se NjAB të plotësohet me staf të mjaftueshëm sipas rregullores për themelimin e NjAB.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Ne kemi marrë parasysh burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të ardhurave të mbledhura nga kategoritë ekonomike. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Burimet e fondeve	19,939,967.00	21,843,466.43	18,716,055.28	17,724,021.08	16,614,800.54
Grante Qeveritare Buxheti	17,904,307.00	17,938,394.06	16,352,367.41	15,369,552.73	14,760,459.82
Financimi përmes huamarrjes	0.00	167,323.20	150,059.85	89,534.10	38,716.43
Të bartura nga viti i kaluar	0.00	1,356,263.33	853,862.77	497,100.39	722,773.94
Të hyrat vetanake	2,035,660.00	2,035,660.00	1,039,575.31	1,550,506.81	1,024,422.97
Donacionet vendore	0.00	260,324.34	238,846.11	111,141.55	65,896.91
Donacionet e jashtme	0.00	85,501.50	81,343.83	106,185.50	2,530.47

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 1,903,500€. Kjo rritje ishte rezultat i të hyrave të bartura nga viti paraprak për 1,356,263€, rritjes së donacioneve të brendshme për 259,747€, rritjes së financimit nga huamarrja prej 167,323€, donacioneve të jashtme për 86,079€ si dhe rritjes së grantit qeveritar për 34,088€.

Në vitin 2020 OB ka shpenzuar 86% të buxhetit përfundimtar ose 18,716,055€, me një rritje 5% në krahasim me vitin 2019.

Shpenzimet gjatë vitit 2020 për menaxhimin e pandemisë Covid-19 ishin 818,823€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me kompensimin e pagave të stafit sipas vendimeve të nivelit qendror, shërbimeve tjera kontraktuese, përkrahjen e familjeve dhe bizneseve me pako ushqimore/financiare, pajisje nën 1,000€, furnizime të ndryshme mjekësore etj. Sidoqoftë, zbatimi i buxhetit mbetet në një nivel të pakënaqshëm dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	19,939,967.00	21,843,466.43	18,716,055.28	17,724,021.08	16,614,800.54
Pagat dhe mëditjet	10,238,810.00	10,313,007.40	10,313,007.40	9,936,267.34	9,772,738.06
Mallrat dhe shërbimet	3,211,496.00	4,398,419.21	3,153,316.61	2,527,731.48	2,006,101.96
Komunalitë	309,035.00	301,442.26	239,622.65	274,878.31	257,593.74
Subvencionet dhe transferet	292,914.00	764,225.73	689,149.07	195,167.00	179,792.00
Investimet Kapitale	4,726,391.00	6,066,371.83	4,320,959.55	4,789,976.95	4,398,574.78
Rezervat	1,161,321.00	0.00	0.00	0.00	0.00


Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë: Buxheti final për paga dhe mëditje ishte rritur për 74,197€. Rritja ishte si rezultat i përshtatjeve buxhetore, rishikimit të buxhetit të vitit 2020 si dhe situatës së krijuar nga pandemia Covid 19;

Buxheti për mallra dhe shërbime ishte rritur për 1,186,923€. Rritja kishte ndodhur si rezultat i rishikimit të buxhetit për 381,195€, nga fondi i rezervave janë bartur 361,961€, nga të hyrat e bartura për 368,763€, nga Master Plani i shpërndarë nga Ministria e Arsimit prej 122,804€ si dhe nga grantet e donatorëve 2,590€. Përderisa duhet theksuar se sipas përshtatjeve buxhetore mallrat janë zvogëluar për 50,390€; Buxheti për shërbimet komunale ishte zvogëluar për 7,593€ si pasojë e përshtatjeve buxhetore, rishikimit të buxhetit të vitit 2020 si dhe situatës së krijuar nga pandemia Covid 19;


Buxheti për subvencione ishte rritur për 471,312€. Rritja kishte ndodhur nga rezervat për 220,000€, si dhe 251,312€ nga rritja e buxhetit sipas vendimeve për menaxhimin e pandemisë; dhe

Buxheti për investimet kapitale ishte rritur për 1,339,981€, rritja ishte si rezultat i të hyrave të bartura për 903,609€, nga rezerva për 395,456€, si dhe pjesa e mbetur nga grantet e donatoreve për 343,235€. Duhet theksuar se buxheti i investimeve kapitale ishte zvogëluar pas rishikimit të buxhetit për 268,024€ si dhe për shkak të përshtatjeve buxhetore për menaxhimin e pandemisë ishte zvogëluar për 34,295€.

Grafiku 2. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2018-2020



Grafiku 3. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2020



Të hyrat e realizuara nga Komuna e Vushtrrisë në 2020 ishin në vlerë 2,116,618€ e që është pothuajse njëjtë sikur në vitin paraprak. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga taksa për grumbullimin e mbeturinave, të hyrat nga qiraja etj. Komuna kishte edhe të hyra të arkëtuara nga institucionet tjera në emër të komunës si në vijim: gjobat në trafik 198,861€, dhe gjokatat nga gjykatat 11,725€.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Pranimet	2019 Pranimet	2018 Pranimet
Totali i të hyrave	2,035,660.00	2,035,660.00	2,116,618.17	2,122,937.67	1,587,599.50
Të hyrat tatimore	807,268.00	807,268.00	734,351.70	820,800.39	661,711.86
Të hyrat jo tatimore	1,228,392.00	1,228,392.00	1,381,488.38	1,302,137.28	925,753.49
Të hyrat tjera	0.00	0.00	778.09		134.15

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2019 ka rezultuar në 19 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit për vitin 2020, gjashtë (6) rekomandime janë zbatuar; tre (3) ishin në proces dhe dhjetë (10) nuk janë adresuar ende, siç është paraqitur më poshtë në Grafikon 4. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shih Tabelën e rekomandimeve nr. 4.

Grafiku 4. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2020

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2019	Veprimet ndërmarra	Statusi
1.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Rekomandimi C1 Kryetari duhet të siguroj se janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në mënyrë që të gjitha shpenzimet të planifikohen në kategoritë e duhura buxhetore dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate. Këtu duhet të përfshihen planifikimi i mjeteve për kompensimin e pagave jubilarë dhe përcjellëse për ish punëtorët që nuk janë kompensuar si dhe ata që janë në prag të pensionimit, si dhe klasifikimi/ndarja e qartë e projekteve kapitale nga shpenzimet tjera si	Në raportin e vitit 2020 kjo çështje është trajtuar te theksimi i çështjes në kuadër të keqklasifikimeve.	Nuk është adresuar

		subvencionet apo mallrat dhe shërbimet.		
2.	Të hyrat	Rekomandimi C2 Kryetari duhet të sigurojë kontrolle shtesë në departamentin e tatimit në pronë, në mënyrë që të dhënat në sistemin ProTax të jenë të harmonizuara me rregulloren e tatimit në pronën e paluajtshme të Komunës dhe me ligjin, dhe të gjitha rastet e tilla të korrigjohen.	Gjetja për zbritjen prej 15,000€ në dy njësi të banimit të një tatimpaguesi fizik është identifikuar gjatë vitit 2020, përderisa aspektin e mos harmonizimit të rregullores komunale me sistemin ProTax nuk e kemi identifikuar gjatë vitit 2020.	Pjesërisht i zbatuar
3.	Të hyrat	Rekomandimi A1 Kryetari duhet të siguroj mekanizma efektiv për inspektimin e kuotës së përcaktuar prej 20% të objekteve siç kërkohet me ligjin e ri si dhe të rrisë kontrollin e menaxhimit të punëve në teren.	Mos inspektimi i të gjitha pronave të kerkuara nuk është arritur as gjatë vitit 2020.	Nuk është adresuar
4.	Pagat dhe mëditjet	Rekomandimi B1 Kryetari, duhet të siguroj se MSHV përdorën vetëm për punë specifike dhe kontratat nuk zgjasin më shumë se afati i paraparë ligjor. Po ashtu, duhet të ndërmerren veprime që nevojat për pozitat të rregullta të adresohen në Ministri të Financave gjatë planifikimit buxhetor dhe të sigurohet se buxhetohen dhe paguhen nga kategoria e pagave e mëditjeve.	Kjo çështje nuk është trajtuar në raportin e vitit 2020 ndonëse staf të angazhuar sipas MSHV-ve janë vërejtur edhe gjatë vitit 2020.	Nuk është i aplikueshëm më
5.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Rekomandimi B2 Kryetari, duhet të sigurojë kontrolle shtesë të monitorimit në mënyrë që të gjitha mallrat dhe shërbimet të pranohen sipas kushteve të kontraktuara, dhe në rastet e pajustificuara të vonesave në liferim, të aplikohen ndëshkimet e përcaktuara me kontratë.	Nuk kemi hasur raste të tilla gjatë vitit 2020.	I zbatuar
6.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Rekomandimi B3 Kryetari duhet të siguroj që të bëhet monitorimi i zbatimit të kontratave përmes hartimit të raporteve nga menaxherët përkatës, dhe se asnjë pagesë të	Nuk kemi hasur raste të tilla gjatë vitit 2020.	I zbatuar

		mos ekzekutohet pa u siguruar dëshmitë e mjaftueshme se dispozitat e kontratës po zbatohen nga ana e OE.		
7.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Rekomandimi B4 Kryetari duhet të thelloj bashkëpunimin me MF, për të siguruar që mjetet për kryerjen e obligimeve që dalin nga marrëveshja kolektive të buxhetohen dhe të paguhen me kohë dhe nga kategoria e pagave dhe mëditjeve, për të shmangur keqklasifikimin dhe shpenzimet e panevojshme.	Për vitin 2020 kjo çështje është trajtuar te keqklasifikimi i shpenzimeve në kuadër të theksimit të çështjes.	Nuk është i aplikueshëm më
8.	Subvencionet dhe transferet	Rekomandimi C3 Kryetari duhet të sigurojë që procesi i vlerësimit të aplikuesve të dokumentohet me dëshmi përkatëse duke siguruar në të njëjtën kohë të mos shkelet parimi i konkurrencës, si dhe përfitues të subvencioneve të jenë vetëm aplikuesit që përmbushin kriteret e përcaktuara në thirrjen publike. Po ashtu, Kryetari duhet të ndërtojë mekanizma mbikëqyrës për tu siguruar se subvencionet e dhëna arrijnë qëllimet e synuara.	Mangesi në vlerësimin e aplikuesve kemi hasur edhe në vitin aktual përderisa aspektet tjera të gjetjes nuk i kemi hasur gjatë vitit 2020.	Pjesërisht i zbatuar
9.	Investimet kapitale	Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e projekteve janë në njohuri me kërkesat ligjore për prokurimin publik (kjo mund të bëhet me anë të trajnimeve) dhe se çdo ndryshim në kushtet e kontratës para ose gjatë periudhës së zbatimit do të bëhet vetëm pas njoftimit të zyrës së prokurimit dhe marrjes së aprovimit nga Zyrtari Administrativ.	Nuk kemi hasur raste të tilla gjatë vitit 2020.	I zbatuar
10.	Investimet kapitale	Rekomandimi B5 Kryetari duhet të sigurojë se për të gjitha aktivitetet e prokurimit që kanë të bëjnë me punë, të mos iniciohen procedurat pa u siguruar specifika të qarta sipas projektit ekzekutues të cilat do të ndikonin në eliminimin e vonesave dhe të kostove shtesë.	Gjendja e njejtë është përsëritur edhe në vitin aktual.	Nuk është adresuar
11.	Investimet kapitale	Rekomandimi A3 Kryetari duhet të siguroj se menaxherët e kontratave dhe çertifikuesi aplikojnë kontrolle efektive në procesin e shpenzimit të parasë publike për tu siguruar se pagesat bëhen vetëm sipas çmimeve	Raste të ngjajshme kemi vërejtur edhe gjatë vitit 2020.	Nuk është adresuar

		të kontraktuara dhe punëve/furnizimeve të realizuara. Po ashtu, për gabimet financiare dhe ndryshimet e identifikuar, komuna duhet të sigurohet se do të bëhet kthimi i mjeteve financiare në buxhetin e komunës dhe realizohen aprovimet e nevojshme për kontratat të cilat ende nuk janë përmbyllur.		
12.	Investimet kapitale	Rekomandimi A4 Kryetari duhet të sigurojë kontrollë shtesë në mënyrë që kontratat të nënshkruhen vetëm atëherë kur ekzistojnë fonde që sigurojnë ekzekutimin e tyre, pa marrë parasysh nëse financimi i tyre është nga të hyrat vetanake apo fonde tjera të financimit.	Nuk kemi hasur raste të tilla gjatë vitit 2020.	I zbatuar
13.	Investimet kapitale	Rekomandimi B6 Kryetari duhet të siguroj që mos të fillohen projektet pa u siguruar për çështjet e problemeve pronësore, të hartohen specifika adekuate të projekteve dhe se menaxherët e kontratave formalizojnë procesin e shtyrjes së afateve kur ato janë të justifikuar nga ana e Komunës. Po ashtu, duhet të aplikohen penalet për vonesat e pa arsyetura.	Gjendja e njejtë është përsëritur edhe në vitin 2020.	Nuk është adresuar
14.	Çështjet përbashkëta	Rekomandimi A5 Kryetari duhet të sigurojë që të respektohen kërkesat e paraqitura në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit, në mënyrë që vetëm operatorët që kanë përbushur të gjitha kushtet të shpërblehen me kontratë.	Nuk kemi hasur raste të tilla gjatë vitit 2020.	I zbatuar
15.	Çështjet përbashkëta	Rekomandimi A6 Kryetari duhet të siguroj që ndarja e detyrave dhe përgjegjësive në aktivitetet e prokurimit të bëhet në përputhje me kërkesat ligjore të prokurimit, në mënyrë që të shmangët mundësia e konfliktit të detyrave.	Raste të ndarjes jo të drejtë të detyrave në aktivitetet e prokurimit kemi hasur edhe në vitin 2020.	Nuk ka filluar zbatimin
16.	Pasuritë	Rekomandimi C4 Kryetari, duhet të sigurohet që do të bëhet azhurnimi i regjistrit të pasurive kapitale konform gjetjeve të auditimit të trajtuara më lartë për të siguruar se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive komunale. Po	Aspekti i mosregjistrimit të të gjitha pasurive kapitale dhe jo kapitale është përsëritur edhe në vitin 2020, përderisa	Pjesërisht i zbatuar

		ashtu duhet siguruar se procesi i inventarizimi dhe vlerësimit të pasurive do të kryet sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore.	aspektet tjera në gabimin e regjistrimeve nuk i kemi hasur gjatë vitit 2020.	
17.	Llogaritë arkëtueshme	Rekomandimi B7 Kryetari, duhet të sigurojë efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme. Hartimi dhe aplikimi i programeve dhe procedurave të qarta për mënyrën e menaxhimit dhe arkëtimit të tyre, do të ndihmonte në këtë drejtim.	Gjendja e njejtë është evidentuar edhe gjatë vitit 2020.	Nuk është adresuar
18.	Obligimet papaguara	Rekomandimi C5 Kryetari, duhet të sigurojë kontrolle shtesë në ekzekutimin e pagesave, për të eliminuar vonesat në pagesën e faturave.	Nuk kemi hasur raste të tilla gjatë vitit 2020.	l zbatuar
19.	Auditimi Brendshëm	Rekomandimi A7 Kryetari, duhet të sigurojë se për pozitat e kërkuara do të bëhen planifikimet buxhetore me kohë dhe se Njësia e Auditimit të Brendshëm do të plotësohet me staf të mjaftueshëm sipas rregullores në fuqi.	Gjendja e njejtë është evidentuar edhe gjatë vitit 2020.	Nuk ka filluar zbatim

Nr	Fusha Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020
1.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë kontrolle shtesë në departamentin e tatimit në pronë, në mënyrë që të dhënat në sistemin ProTax të jenë të harmonizuara me rregulloren e tatimit në pronën e paluajtshme të Komunës dhe me ligjin, dhe të gjitha rastet e tilla të korrigjohen.
2.	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj mekanizma efektiv për inspektimin e kuotës së përcaktuar prej 20% të objekteve siç kërkohet me ligjin e ri si dhe të rrisë kontrollin e menaxhimit të punëve në teren.
3.	Të hyrat	Kryetari të sigurojë përmirësimin e kontrolleve të brendshme në mënyrë që paratë e gatshme të grumbulluar në arkë të dorëzohen dhe të depozitohen në bankë sipas kërkesave të rregullës financiare për të hyrat.
4.	Të hyrat	Kryetari të sigurojë përmirësimin e kontrolleve të brendshme në këtë fushë në mënyrë që hyrat të klasifikohen drejtë në përputhje me kodet përkatëse ekonomike të përcaktuara me planin kontabël të Thesarit/SIMFK.
5.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari të sigurojë përmirësimin e kontrolleve të brendshme në procesin e vlerësimit dhe përzgjedhjes së tenderëve konform kritereve të përcaktuara në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë.
6.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari të sigurojë ndarjen e drejtë të detyrave në procesin e menaxhimit të aktiviteteve të prokurimit dhe kontratave konform respektimit të kritereve ligjore dhe rregullative të prokurimit publik.
7.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë që procesi i vlerësimit të aplikuesve të dokumentohet me dëshmi përkatëse duke siguruar në të njëjtën kohë të

		mos shkelet parimi i konkurrencës, si dhe përfitues të subvencioneve të jenë vetëm aplikuesit që përmbushin kriteret e përcaktuara në thirrjen publike.
8.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se për të gjitha aktivitetet e prokurimit që kanë të bëjnë me punë, të mos iniciohen procedurat pa u siguruar specifika të qarta sipas projektit ekzekutues të cilat do të ndikonin në eliminimin e vonesave dhe të kostove shtesë.
9.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se menaxherët e kontratave dhe çertifikuesi aplikojnë kontrolle efektive në procesin e shpenzimit të parasë publike dhe menaxhimin e kontratave për tu siguruar se pagesat bëhen vetëm sipas çmimeve të kontraktuara dhe punëve/furnizimeve të realizuara. Po ashtu, për gabimet financiare dhe ndryshimet e identifikuar, komuna duhet të sigurohet se do të bëhet kthimi i mjeteve financiare në buxhetin e komunës dhe realizohen aprovimet e nevojshme për kontratat të cilat ende nuk janë përmbyllur.
10.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj që mos të fillohen projektet pa u siguruar për çështjet e problemeve pronësore, hartimit të specifikave adekuate të projekteve dhe se menaxherët e kontratave formalizojnë procesin e shtyrjes së afateve kur ato janë të nevojshme nga ana e Komunës. Po ashtu, për vonesat e pa arsyetuara, të aplikohen penalet.e parapara me kontratë.
11.	Pasuritë	Kryetari, duhet të sigurohet që do të bëhet azhurnimi i regjistrit të pasurive kapitale konform gjetjeve të auditimit të trajtuara me lartë për të siguruar se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive komunale.
12.	Pasuritë	Kryetari, duhet siguruar se procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive do të kryhet sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore.
13.	Llogaritë arkëtueshme	Kryetari, duhet të sigurojë efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme. Hartimi dhe aplikimi i programeve dhe procedurave të qarta për mënyrën e menaxhimit, regjistrimit dhe arkëtimit të tyre, do të ishin disa nga masat që mund të sjellin përmirësime.
14.	Auditimi Brendshëm	Kryetari, duhet të sigurojë se për pozitat e kërkuara do të bëhen planifikimet buxhetore me kohë dhe se NjAB të plotësohet me staf të mjaftueshëm sipas rregullores për themelimin e NjAB.

Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm



Qerkin Morina, Ndhmës Auditor i Përgjithshëm



Zukë Zuka, Udhëheqës i Auditimit



Ylber Sadiku, Udhëheqës i ekipit




Muharrem Qyqalla, Anëtar i ekipit



Arben Hundozi, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



KOMUNA VUSHTRRI

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2020 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Vushtrrisë, për vitin 2020 (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.



Z. XHAFER TAHIRI,

Kryetari i Komunës së Vushtrrisë

Data: 05.07.2021

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet.⁷ Ky opinion duhet të veçohet nga opinioni nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, d.m.th. opinioni mund të modifikohet në lidhje me çështjen(t) e pajtueshmërisë, por mund të mos modifikohet në lidhje me besueshmërinë e pasqyrave financiare (ose anasjelltas).

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E VUSHTRRIË

Për Zyren Kombëtare të Auditimit

Nga z. Xhafer Tahiri, Kryetar I Komunës

**PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E
REKOMANDIMEVE**

**të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra
Kombëtare e Auditimit**

Nr	Çështja	Gjetja	Rekomandimet	Veprimet e planifikuara për t'u ndërmarrë	Zyrtari/jët përgjegjës	Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit
1	<p>Çështja A1 - Vonesa në depozimin e parasë së gatshme në llogarinë bankare</p>	<p>Neni 11 i Rregullës Financiare 03/2010 për të hyrat përcakton që paratë e grumbulluara nga Organizatat Buxhetore (OB) nga arkëtimet për shërbime në lartësi deri 10€, duhet në fund të ditës të depozitohen në llogarinë bankare.</p> <p>Në dy raste kemi evidentuar se paratë e arkëtuara nga ekstraktet e lindjes dhe participimi në OKMF nuk ishin depozituar me kohë, në arkën kryesore rjedhimisht në bankë, vonesat ishin nga pesë (5) ditë deri afërsisht dy (2) muaj, ndonëse vlerat monetare nuk ishin materiale.</p> <p>Përkatësisht: Të hyrat e arkëtuara nga participimet në OKMF, nga data 10.11.2020-17.11.2020, në vlerë 607€, janë depozituar në bankë me datë 17.11.2020;</p> <p>☒ Të hyrat e arkëtuara nga ekstraktet e lindjes, nga data 13.03.2020-06.05.2020, në vlerë 83€, janë depozituar në bankë me datë 06.05.2020.</p> <p>Kjo ka ndodhur si shkak i kontrolleve të brendshme jo efektive përkatësisht rrethanave të krijuara si rezultat i pandemisë dhe vështirësive në organizimin e stafit.</p>	<p>Kryetari të sigurojë përmirësimin e kontrolleve të brendshme në mënyrë që paratë e gatshme të grumbulluara në arkë të dorëzohen dhe të depozitohen në bankë sipas kërkesave të rregullës financiare për të hyrat.</p>	<p>Në pajtim me Nenin 11 i Rregullës Financiare 03/2010, në fund të ditës, paratë e grumbulluara në arkat e komunës do të depozitohen në bankë. Hapi i parë për zbatimin e këtij rekomandimi është hartimi i orarit të përshatshëm të zyrtarëve në mënyrë që t'u krijohen kushte që të zbatohet rekomandimi.</p>	<p>Drejtorja për Administratë dhe Personel</p> <p>Drejtorja për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale</p>	<p>Gusht 2021</p>

2	<p>Çështja A2 - Regjistrimi i të hyrave në kode ekonomike jo përkatëse</p>	<p>Me rregullat e Thesarit dhe Udhëzimit administrativ NR. 19/2009 për planin kontabël të SIMFK-së janë përcaktuar kategoritë dhe kodet ekonomike sipas llojit për regjistrim.</p> <p>Nga testimi i të hyrave të arkëtuara në vlerë 8,560€ për leje mjedisore komunale, kemi identifikuar se ishin klasifikuar gabimisht në kodin ekonomik të lejeve ndërtimore. Rrijedhimisht kemi evidentuar se të gjitha arkëtimet për leje mjedisore komunale në vlerë të përgjithshme prej 38,912€, arkëtimet nga lejet për legalizim në vlerë 15,036€ si dhe nga lejet për rrëhime në vlerë 3,328€, nuk ishin klasifikuar në kodet adekuata ekonomike sipas planit kontabël por ishin regjistruar të gjitha në kodin e lejeve ndërtimore.</p> <p>Kjo ka ndodhur si shkak i moskujdesit të duhur në përdorimin e kodeve adekuata ekonomike si dhe praktikave të zbatuara deri më tani.</p>	<p>Kryetari të sigurojë përmirësimin e kontrollleve të brendshme në këtë fushë në mënyrë që të hyrat të klasifikohen drejtë në përputhje me kodet përkatëse ekonomike të përcaktuara me planin kontabël të Thesarit/SIMFK.</p>	<p>Drejtoria për Buxhet dhe Financa është siguruar për regjistrimin adekuat të të hyrave nga lejet mjedisore, rrëhimi dhe legalizimi i objekteve në kodet ekonomike përkatëse.</p> <p>Për më shumë, bllokat me uniref do të shtyphen për të hyrat nga lejet mjedisore, rrëhimi dhe legalizimi i objekteve.</p>	<p>Drejtoria për Buxhet dhe Financa ZKF</p>	<p>Mars 2021</p>
3	<p>Çështja B1 - Dobësi në procesin e veprimtarive inspektuese të objekteve brenda territorit të Komunës</p>	<p>Sipas nenit 15.2 të Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, veprimtaritë inspektuese kryhen çdo vit për të paktën njëzetë përqind (20%) të të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës.</p> <p>Komuna në vitin 2020 nuk ka arritur të plotësoj këtë kriter të kryerjes së veprimtarive inspektuese, ngase nga totali 22,480 objekteve të regjistruara janë verifikuar 3,377 objekte apo rreth 15%.</p> <p>Kjo ka ndodhur si shkak i dobësi në organizimin e veprimtarive inspektuese ndër të tjerë edhe si rezultat i ndikimit të</p>	<p>Kryetari duhet të siguroj mekanizma efektiv për inspektimin e kuotës së përcaktuar prej 20% të objekteve siç kërkohet me ligjin e ri si dhe të rrisë kontrollin e menaxhimit të punëve në teren.</p>	<p>Sektori i tatimit në pronë përkundër vëzhgësive me staf dhe menaxhment, nën drejtimin e Drejtorit të DBF, do të përpilojë një plan vjetorë të inspektimeve. Ne tani kemi angazhuar punëtor shtesë me qëllim për të realizuar verifikimin e 20% të pronave të komunës në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Drejtori për Buxhet dhe Financa Sektori i TP</p>	<p>Dhjetor 2021</p>

		pandemisë dhe vështrësive në organizimin e stafit.				
4	Çështja C1 - Dobësi në menaxhimin e të dhënave të tatumit në pronë	Neni 11 i Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatumin në Pronën e Paluajtshme, përcakton se njësi e objektit që shëmben si vendbanim parësor për personat fizik, i lejohet zbritja prej 15,000€ nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit. Në një rast kemi identifikuar se zbritja prej 15,000€ ishte aplikuar në dy njësi të banimit të një tatimpaguesi fizik. Kjo ka ndodhur si shkak i kontrolleve të dobëta në këtë fushë lidhur me përditësimin e informacionit të tatimpaguesve në sistem.	Kryetari duhet të sigurojë kontrolle shtesë në departamentin e tatumit në pronë, në mënyrë që të dhënat në sistemin ProTax të jenë të harmonizuara me rregulloren e tatumit në pronën e paluajtshme të Komunës dhe me ligjin, dhe të gjitha rastet e tilla të korrigjohen	Pasigë e kemi identifikuar rastin kemi marrë masa dhe kemi konstatuar se objekti për të cilin kemi edhe gjetje ka qenë i rrenuar dhe për atë shkak ka ndodhur edhe zbritja nga banimi primar. Zyra e TP e ka vërtetuar dhe korrigjuar këtë pronë. Zyra e TP do të kujdeset që raste të tilla mos të përsëriten.	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	Maj 2021
5	Çështja A3 - Dobësi në përbushjen e kriterit të dosjes së tenderit lidhur me vërtetimin tatumor	Në dy aktivitete të prokurimit, kemi identifikuar se nuk ishte respektuar kriteri i përcaktuar në dosjen e tenderit/njoftimin për kontratë, respektivisht të kërkesat e përshtatshmërisë, ku ishte kërkuar "Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e vendit Tuj të themelimit se Ju nuk jeni në vonesë për pagimin e tatimeve, ky vërtetim duhet të jetë jo më i vjetër se 90 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të tenderit, duhet të dorëzohet nga Operatori Ekonomik të cilit synohet dhënia e kontratës". Mangësitë e identifikuara janë gjetur në këto dy aktivitete të prokurimit: Te aktiviteti i prokurimit "Furnizim me material shpenzues për laborator (reagensa)", në vlerë 95,515€, kemi	Kryetari të sigurojë përmirësimin e kontrolleve të brendshme në procesin e vlerësimit dhe përzgjedhjes së tenderëve konform kriterëve të përcaktuara në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë.	Koha kur aktivitetet e cekuar në Çështjen A3 janë realizuar ishte pikë i pandemisë Covid 19, rrijedhimisht ka qenë e pamundur të respektohen të gjitha rregullat duke pas parasysh se shumica e institucioneve nuk funksionin dhe për këtë ne si Prokurim do t'i ndërmarrim masat që kjo çështje mos të përsëritet duke rritur kontrollin, me theks te vegant ne këto çështje.	Drejtoria për Prokurim Publik	Janar 2021

	<p>identifikuar se vërtetimi tatimor ishte prezantuar me validitet të skaduar përtej afait 90 ditor nga data e dorëzimit të tenderëve;</p> <p><input checked="" type="checkbox"/> Te aktiviteti i prokurimit "Furnizim me material higjienik dhe mbrojtës për nevoja të personelit të administratës komunale pas situatës së krijuar si pasojë e përhapjes së sëmundjes infektive Corona Virus Covid 19 ", në vlerë 27,331€, kemi identifikuar se vërtetimi tatimor ishte prezantuar me borxhe tatimore apo obligime tjera tatimore të pashlyera. Kjo ka ndodhur si rezultat i kontrolleve të brendshme jo efektive në procesin vlerësimi të tenderëve konform kriterëve të përcaktuara në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë.</p>				
<p>6</p> <p>Çështja A4 - Dobësi në menaxhimin e aktivitetëve të prokurimit dhe kontratave</p>	<p>Neni 62.1 Rregullave dhe udhëzuesit operativ për prokurimin publik (RrUOPP), për ndarje të detyrave, ndër të tjera përcakton se "Një anëtar i komisionit të vlerësimit nuk mund të emërohet si Menaxher i projektit" gjithashtu "Një zyrtar nga një departament i cili ka përgatitur specifikimet dhe/ose termat e referencës, ose ka përcaktuar standardet e cilësisë, ose vizatimet e përgatitura nuk mund të marrë pjesë si një anëtar i komisionit të vlerësimit". Vlerësimi të tenderëve.</p> <p>Kjo ka ndodhur si rezultat i mos disponueshmërisë së stafit të mjaftueshëm për ndarje të drejtë të detyrave në procesin e zhvillimit të aktivitetëve të prokurimit.</p> <p>Në dy procese të zhvillimit të aktivitetëve të prokurimit dhe kontratave kemi</p>	<p>Kryetari të sigurojë ndarjen e drejtë të detyrave në procesin e menaxhimit të aktivitetëve të prokurimit dhe kontratave konform respektimit të kriterëve ligjore dhe rregullave të prokurimit publik.</p>	<p>Koha kur aktiviteti i cekuar ne Çështjen A4 është realizuar ishte piku i pandemisë Covid 19 dhe rrjedhimisht ka qene e pamundur te respektohen te gjitha rregullat duke pas institucionin jone punonte e staf esencial sipas vendimeve te Qeveris së Kosovës dhe ishte e pa mundur qe te angazhojmë zyrtar të cilët ishin të liruar nga puna për arsye shëndetësore apo moshën dhe sëmundje kronike eventuale, d.m.th stafi ishte shume i reduktuar dhe ne u detyruam qe te procedojmë me at staf qe e kishim ne dispozicion prandaj ka ndodhur rasti i tillë. Ne do</p>	<p>Drejtoria për Prokurim Publik</p>	<p>Në vazhdimësi</p>

	<p>identifikuar mangësitë në vijim:</p> <p>☒ Te aktiviteti i prokurimit "Furnizim me pako ushqimore dhe higjienike për ndihmë familjeve në nevojë pas situatës së krijuar si pasojë e përhapjes së sëmundjes infektive Corona Virus, Covid 19", në vlerë 49,600€, kryesuesi i komisionit të vlerësimit të tenderëve ishte caktuar po ashtu edhe si menaxher i kontratës;</p> <p>☒ Te aktiviteti i prokurimit "Mirëmbajtja e ndriçimit publik në qytet dhe fshatra, për nevoja të A.K. – Vushtrri", me gnim të peshuar në vlerë 105€, personi i cili ka përgatitur paramasën dhe paralogarinë ishte caktuar edhe kryesues i komisionit të vlerësimit të tenderëve.</p> <p>Kjo ka ndodhur si rezultat i mos disponueshmërisë së stafit të mjaftueshëm për ndarje të drejtë të detyrave në procesin e zhvillimit të aktiviteteve të prokurimit.</p>		<p>t'i ndërmarrim te gjitha masat qe kjo mos te përsëritet tani kemi nxjerrë një tabel e cila do te na ndihmon qe mos te kemi lëshime te tilla.</p> <p>Ndërsa, sa i përket aktivitetit tjetër te cekuar ne ketë çështje kjo ka ndodhur sepse ne Institucionin tone kemi mungesë evidente te ingjervrae te elektros dhe ne ketë situatë kemi qene gati të detyruar te veprojmë kesi soj apo te angazhojmë staf nga jashtë institucionit e ne ketë rast do te na shkakatonet shpenzime bugetore dhe do te na merte kohen deri ne realizimin e këtij aktiviteti. Ne te ardhëm ne këto raste ne rast se nuk do te kemi staf profesione përkatës te brendshëm do t'i shijojmë te gjitha alternativat ne mënyrë qe mos te përsëritet e rekomandimi i tillë</p>		<p>E zbatuar.</p>
<p>7</p> <p>Çështja C2 - Dobësi në menaxhimin e subvencioneve</p>	<p>Për tu kualifikuar për mbështetje financiare publike aplikuesi duhet ti plotësoj kriteret e përgjithshme të përcaktuara me rregullore dhe thirrje publike.</p> <p>Nga testimi i thirrjes publike për financimin e projekteve të OIQ-ve në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, kemi identifikuar një rast në të cilin dokumentacioni i kërkuar ishte dorëzuar</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë që procesi i vlerësimit të aplikuesve të dokumentohet me dëshmi përkatëse duke siguruar në të njëjtën kohë të mos shkalet parimi i konkurrencës, si</p>	<p>Konsiderojmë se ky gabim ka qenë vetëm një gabim teknik në aplikacion, për ndryshe aplikimi është bërë brenda afatit (04.12.2020) dhe kërkesa ka qenë e kompletuar.</p> <p>Edhe në vijim do të kujdesemi për respektimin e rregullores komunale</p>	<p>Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport</p>	

	<p>pas afatit të përcaktuar me thirrje publike. Vendimi për caktimin e përfutjesit ishte nxjerrë me dt. 11.12.2020, ndërsa dokumentet të cilat nuk ishin dorëzuar me kohë janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Aplikacioni me dt. 12.12.2020; 2. Deklarata mbi financimin e dyfishtë me dt. 12.12.2020; si dhe 3. Çertifikata nga evidencia e personave kundër të cilëve është duke u zhvilluar procedura penale dhe personave të dënuar nga gjykata me dt. 14.12.2020. <p>Kjo gjendje ishte si pasojë e mungesës së kontrolleve dhe pakujdesisë së komisionit të themeluar për vlerësimin e aplikacioneve.</p>	<p>dhe përfutjes të subvencioneve të jenë vetëm aplikuesit që përmeshin kriteret e përcaktuara në thirrjen publike.</p>	<p>01/2018 për subvencione si dhe zbatimin e praktikave të mira.</p>		
<p>8</p> <p>Çështja B2 - Vonesa në realizimin e kontratave</p>	<p>Kontratat përcaktojnë afatet për realizimin e tyre. Në tre kontrata të testuara, kemi evidentuar se është dashur të përfundonin në vitin 2019/2020. Nga pagesat e testuara kemi evidentuar vonesa në realizimin e tre (3) kontratave të cilat është dashur të përfundonin në vitin 2019/2020, mirëpo ende nuk ishin përmbyllur as gjatë kohës që ne ishim në ekzekutim të auditimit (mars 2021). Vonesat kanë të bëjnë me projektet: (1) "Ndërtimi i QMF-së në Vushtrri" projekt dy vjeçar prej 346,222€; (2) "Asfaltimi i rrugës Vushtrri-Nadakoç-Pestovë faza e parë" prej 282,347€, dhe (3) "Ndërtimi i sheshit nuk kishte aplikim të penaleve. Shkaqet e vonesave kryesisht ishin për shkak të menaxhimit jo adekuat të komunës lidhur me problemet pronësore, specifike të punëve, pa përgjegjshmërisë së OE, kushteve atmosferike etj. Ndërsa, mos formalizimi i vonesave ishte për shkak të mungesës së</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë që mos të fillohen projektet pa u siguruar për çështjet e problemeve pronësore, hartimit të specifikeve adekuata të projekteve dhe se menaxherët e kontratave formalizojnë procesin e shtyrjes së afateve kur ato janë të nevojshme nga ana e Komunës. Po ashtu, për vonesat e pa arsyetura, të aplikohen penalet e parapara me kontratë.</p>	<p>(1) Ndërtimi i i "QKMF - së në Vushtrri" është i paraparë të përfundoj në vitin 2020 përderisa si pasojë e pandemisë kemi pasur ngecje në realizimin e projektit, gjithashtu kemi pasur edhe një kërkesë nga Drejtoria e Shëndetësisë për ndryshimet në hyrje të bodrumit (të mbyllet hyrja nga rampa me vetura dhe të shfrytëzohet vetëm hyrja kryesore). Për këtë ndryshim kemi edhe aprovimin nga ZKA. Realizimi përfundimtar i këtij projekti, me ndryshimin e aprovuar do të jetë jo më vonë se fundi i muajit Gusht 2021</p>	<p>Drejtoria për Prokurim Publik Drejtoria për Planifikim Urban Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale Drejtoria për Shërbime Publike Drejtoria për Arsimit</p>	<p>Korrik 2021</p>

	<p>njohurive të menaxherëve të kontratave lidhur me kërkesat ligjore. Ahmet Krasniqi në qytetin e Vushtrisë" prej 93,664€.</p> <p>Duhet theksuar se në asnjërin prej këtyre rastëve nuk kishte kërkesë/aprovim për zgjatjen e afatit për realizimin e kontratave, siç përcaktohet në nenin 18 të dosjes standarde të tenderit. Po ashtu, nuk kishte aplikim të penaleve.</p> <p>Shkqet e vonesave kryesisht ishin për shkak të menaxhimit jo adekuat të komunës lidhur me problemet pronësore, specifkave të punëve, pa përgjegjshmërisë së OE, kushteve atmosferike etj. Ndërsa, mos formalizimi i vonesave ishte për shkak të mungesës së njohurive të menaxherëve të kontratave lidhur me kërkesat ligjore.</p>		<p>Vushtrri-Nadakofc-Pestovë faza e parë" kanë ardhur si pasojë e tokave të përzira me komasacion dhe punimi i tokave me harta te vjetra me crast nga banorët e atij lokaliteti na u janë shfaqur pengesa dhe kemi pasur vonesa të detyrueshme e që më vonë janë zgjidhur në bashkëpunim me komunitetin.</p> <p>Vonesat e mëtuqeshme nga Operatori Ekonomik të paarsyeshme na kanë detyruar që me datë 29.07.2021 kjo kontratë të ndërprehet dhe ndaj OE janë marrë masat konform kushteve te kontratës për vonesat e paarsyeshme. (Shihe Venimin nr. 425/21 date 28.08.2021)</p> <p>(3) "Ndërtimi i sheshit "Ahmet Krasniqi". Vonesat e shkaktuara në realizimin e projektit kanë ardhur si pasojë e pandemisë e në disa raste edhe për shkak të kushteve atmosferike.</p> <p>Vonesa kemi pasur edhe në punimin e bazamentit dhe vendosjen e shtatores së Kolonel Ahmet Krasniqi e që është kontraktur nga Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve e që</p>	<p>Korrik 2021</p>
--	--	--	--	--------------------

			<p>rriedhimisht një pjesë e punës në shesh është dashur të mos vazhdohet deri në vendosjen e shtatorës. Komuna e Vushtrisë në të ardhmen do t'i aplikoj penale për çdo vonesë e cila konsiderohet e paarsyeshme dhe do të bëjë korrigjimin planit dinamik të ofruar nga OE</p>		
<p>9</p> <p>Çështja B3 - Mungesa e projektit ekzekutues</p>	<p>Neni 20.10 i RrUOP kërkon që specifikat teknike për kontratën e punës, duhet të përfshijnë një projekt ekzekutues si pjesë substanciale të veten.</p> <p>Ne kemi identifikuar se në pesë (5) kontrata pune komuna nuk kishte hartuar projektin ekzekutues, por i kishte zhvilluar procedurat e prokurimit duke përgatitur vetëm paramasën dhe paralogarinë.</p> <p>Mungesa e projekteve ekzekutuese kryesisht ishte te renovimet dhe ndërtimi i rrugëve.</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë se për të gjitha aktivitetet e prokurimit që kanë të bëjnë me punë, të mos iniciohen procedurat pa u siguruar specifika të qarta sipas projektit ekzekutues të cilat do të ndikojnë në eliminimin e vonesave dhe të kostove shtesë.</p>	<p>Për shkak të ankesave të Operatorëve Ekonomik lidhur me projektin "Hartimi i Projekteve" drejtuar OSHP-së, Komuna e Vushtrisë tash e një vit e gjysmë nuk ka kompani të jashtme që harton projektet për nevoja të drejtorive komunale.</p> <p>Në këtë fazë jemi afër nënshkrimit të kontratës për Hartim të Projekteve me OE dhe se të gjitha projektet tjera do të hartohen paraprakisht para fillimit të procedurave të prokurimit.</p>	<p>Drejtoria për Prokurim Publik</p>	<p>Jemi në fazën e nënshkrimit të kontratës.</p>
<p>10</p> <p>Çështja B4 - Mangësi në ekzekutimin/menaxhimin e kontratave</p>	<p>Rregulla financiare Nr. 01/2013 për shpenzimin e parasë publike, nenet 22 deri 26, ndër të tjera përcaktojnë se paraprakisht duhet të bëhet pranimi i mallrave/punëve pastaj duhet të bëhet pagesa. Neni 61.21 i RrUOP specifikon se "Ndryshimi i kontratës i referohet një ndryshimi në termat dhe kushtet e një kontrate të shpërblyer", neni 61.22 thotë</p>	<p>Kryetari duhet të siguroj se menaxherët e kontratave dhe certifikuesi, aplikojnë kontrolle efektive në procesin e shpenzimit të parasë publike dhe</p>	<p>Te (1) "Ndërtimi i fushës ndihmëse të stadiumit të futbollit". Poz.15, ku përfshihen edhe muret ndarëse me trashësi t=12cm të brendshme që janë zëvendësuar me mure me trashësi t=20cm, ky ndryshim përfshinë muret</p>	<p>Drejtoria për Prokurim Publik Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural</p>	<p>Mars 2021</p>

	<p>se "ndryshimi i kontratës do të përgatitet nga departamenti i prokurimit", ndërsa nëni 61.23 thotë se kjo mund të bëhet "vetëm pas marrjes së aprovimit nga Zyrtari Kryesor Administrativ".</p> <p>Në tre (3) kontrata kemi evidentuar mangësi në ekzekutimin/menaxhimin e kontratave si në vijim:</p> <p>☒ Te kontrata "Ndërtimi i fushës ndihmëse të stadiumit tëfutbollit" prej 118,527€, kemi evidentuar se te pjesa përndërtimin e zhveshtoreve, pozicioni 15 ishte paguar në tërësi sasia e kontraktuar, ndërsa nuk ishte bërë muratimi i komplet mureve të brendshme. Ndërsa te pozicioni 21 që kishte të bënte me Furnizimin dhe vendosjen e tregullave (kulmi), ishte ndryshuar dhe kulmi ishte bërë me llamarinë. Ky ndryshim nuk është evidentuar në situacionin që ishte procesuar për pagesë dhe nuk kishte ndonjë aprovim formal.</p> <p>☒ Te kontrata "Ndërtimi i sallës sportive në SHMU-1" prej 260,666€, kemi evidentuar disa pozicione të cilat ishin paguar në tërësi por që nuk ishin kryer punët. Pozicionet që ishin paguar pa u kryer punët kishin të bënin me punët e zdrëktuarisë përkatësisht pozicionet: 13.2, 13.3, 13.7, 13.8, 13.9, 13.10, 13.11, 13.12 dhe 13.3. Vlera totale e këtyre pozicioneve të paguara por që nuk ishin punuar ishte 3,320€.</p> <p>☒ Te kontrata "Ndërtimi i objektivit për ruajtjen e patates në fshatin Pestovë" prej 157,237€, kemi evidentuar se pozicioni 1.2 i paramasës së kontraktuar (gimi i kontraktuar është jo normalisht i lartë)</p>	<p>menaxhimin e kontratave për tu siguruar se pagesat bëhen vetëm sipas çmimeve të kontraktuara dhe punëve/furnizimeve të realizuara. Po ashtu, për gabimet financiare dhe ndryshimet e identifikuara, komuna duhet të sigurohet se do të bëhet kthimi i mjeteve financiare në buxhetin e komunës dhe realizohen aprovimet e nevojshme për kontratat të cilat ende nuk janë përmbyllur.</p>	<p>ndarëse që duhen të jenë me trashësi t=20cm, kurse muret ndarëse të nyeve sanitare dhe tushkabinave do të bëhen me ndarje fizike nga elemente të parfabrikuara nga plastika të cilat janë të përfshira në fazën e dytë e që ka qenë kërkesë e klubit me çdo kusht. Krahas kërkesës së Klubit të Futbollit, me këtë ndryshim jemi pajtuar edhe me Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të</p> <p>ZKA i Komunës së Vushtrisë marrë Vendim për themelimin të Grupit Punues me Nr. 808/21 të dt. 21.07.2021 për përgaditjen e Planit të Veprimit për implementim të Rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm nga Raporti për Pasqyrat Financiare të Komunës së Vushtrisë.</p> <p>Për Rekomandimin e lartshënuar Grupi Punues në përbërje prej 11 (njëmbëdhjetë) anëtarëve së bashku me Menaxherin e Kontratës z. Ekrem Miftari kanë shqyrtuar dhe analizuar këtë pozicion me grast obligojnë Operatorin Ekonomik që Pozicioni 21 sipas kontratës për furnizim</p>	<p>Drejtoria për Arsim</p> <p>Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport</p>	
--	---	---	---	---	--

			<p>dhe vendosje të tregullave i ndryshuar në lllamarinë, të kthehet në pozicionin e kontraktuar (mbulesë me tregulla).</p> <p>Me që kjo Kontratë ka vetem Pranimin Teknik të Përkohshëm të datës 17.11.2020 ndërsa Pranimi Teknik Përfundimtar do të bëhet jo më vonë se 17.12.2021, Grupi Punues së bashku me Menaxherin e Kontratës obligojnë OE që ndryshimi i pozicionit 21 nga lllamarinë në tregulla të përfundohet para datës së Pranimit Teknik Përfundimtar.</p>		
	<p>ishite paguar në tërësi për pozicionin që pëmbante punë për pastrimin e terrenit në fund të punimeve, ndërsa nuk ishte dashur të paguhet. Nga menaxheri i kontratës jemi njoftuar se objekti nuk është duke u ndërtuar në vendin e paraparë me projekt dhe se mungonin aprovimet formale nga ZKA për ndryshimin e lokacionit për ndërtim.</p>		<p>(2) "Ndërtimi i sallës sportive në SHMU-1" Nga vizita e datës 12.03.2021 në vendpunishite I analizuam pozicionet të cilat janë në realizim dhe atyre të paguara në situacionin e fundit. Pozicionet të cilat janë të paguara dhe nuk janë të montuara në vend janë si : Operatori ekonomik ka sjellur një pjesë të</p>		

		<p>zdrëktarisë në vend punishte por në kordinim me org. mbigjyrës jemi dakorduar që pa u përfunduar suvatimi i shtresës së parë dhe shtresës nivelizuese mos të montohen. Njëkohësisht ky situacion është i përkohshëm dhe e konsiderojmë se nuk do të ketë impkim në realizimin e projektit. Me datën 13.03.2021 operatori ekonomik ka filluar edhe me pjesën e mbetur për montim të cilat pozicione janë përfunduar deri më 19.03.2021.</p>		
		<p>(3) "Ndërtimi i objektit për ruajtjen e patates në fshatin Pestovë". Me fillimin e punimeve kemi hasur pengesa në realizimin e punive si pasojë e paknaqësisë së banorve të fshatit Pestovë. Me njoftim kemi organizuar edhe takime me palët tjera dhe me kërkesën e fshatit Nedakoc ky objekt është bartur në fshatin e tyre. Me miratimin nga zyra e DRUMM kemi dislokuar vendin e ndërtimit Pozicioni 1.2 është i lartë por vendosja e qmimit nga</p>		

			operatorit ekonomik është pjesë e kontratës sipas paramasës dhe paralogarisë, kurse pagesa e kryer e këtij pozicioni është e përkoshme dhe nëse optaori ekonomik nuk e përfundon sipas paramasës dhe paralogarisë atëherë duhet të penalizohet per pozicionin përfundimtar 1.2.			
11	<p>Cështja B5 - Mangësi në procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive jo financiare</p>	<p>Neni 19.4.3 i Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare përcakton se duhet të bëhet krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen e regjistrave të pasurive jo financiare. Ndërsa neni 21 i po kësaj rregulloreje ka përcaktuar kërkesat për vlerësimin e pasurive jo financiare.</p> <p>Komuna ka kryer procesin e inventarizimit të pasurive jo financiare, mirëpo nuk ishte bërë krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare, siç kërkohet me nenin 19.4.3 të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare. Po ashtu nuk ishte bërë vlerësimi i pasurive jo financiare sipas kërkesave të nenit 21 të kësaj rregulloreje.</p> <p>Magësitë në procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive, kryesisht ishin për shkak të mungesës së njohurive lidhur me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurive jo financiare si dhe mungesës së udhëzuesve të brendshëm lidhur me procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive.</p>	<p>Kryetari, duhet siguruar se procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive do të kryhet sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore.</p>	<p>Në muajin nëntor në bashkëpunim me kryetarin do të emërojmë komisionin për inventarizim dhe komisionin për vlerësimin e pasurisë.</p> <p>DBF dhe Kryetari do të sigurohen që procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive do të realizohet në përputhje me kërkesat e Rregullores 02/2013.</p>	<p>Drejtoria për Buxhet dhe Financa</p>	<p>Nëntor 2021</p> <p>Dhjetor 2021</p>
12	Cështja C3 - Mangësi në	Neni 6.3 i Rregullores për 02/2013 për	Kryetari, duhet të	Te gjitha pasuritë kapitale		



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E VUSHTRRIË

Për : Kuvendin e Komunës

Propozues: Kryetari i Komunës

Hartues : Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport

Tema : Propozim- vendim

Bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, si dhe nenin 41 pika 41.2 shkronja “ç” të Statutit të Komunës , Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datën _____ 2021 merr këtë:

VENDIM

PËR PËRKRAHJE FINANCIARE PËR KLUBIN E HENDBOLLIT “ VUSHTRRIA”

1. Me këtë vendim ofrohet përkrahje financiare në shumë prej gjashtëmijë euro (6000.00 €) për Klubin e Hendbollistik “ Vushtrria “ në Vushtrri.
2. Mjetet financiare të cekura si në pikën paraprake të këtij vendimi do të sigurohen nga buxheti i komunës - kategoria subvencione dhe transfere, në njësitë buxhetore në të cilat ka mjete të lira.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen : Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport.
4. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Nasuf Aliu

Kryesues i Kuvendit

ARSYETIM

Klubit i Hendbollit "Vushtrria" – Femrat, në Vushtrri, më datë 17.09.2021, i është drejtuar Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, për mbështetje financiare, me qëllim të realizimit të dy ndeshjeve ndërkombëtare, në cilësinë e Kampionit të Kosovës në Hendboll për Femra. Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport, në konsultim edhe me kryetarin e komunës kanë shqyrtuar këtë kërkesë dhe duke vlerësuar rëndësinë e zhvillimit të sportit, e në veçanti hendbollit, e kanë vlerësuar të drejtë dhe të domosdoshme që kjo kërkesë gjejë mbështetje, në mënyrë që këtyre sportistëve t'u bëhet e mundur të arrijnë suksese ndërkombëtare, duke shkuar atje për të përfaqësuar jo vetëm Vushtrrinë, por edhe si kampion të Kosovës.

Klubit i Hendbollit "Vushtrria" Femrat, nga Vushtrria, do të zhvillojë ndeshjet në kuadër të EHF CUP, si kampion i Kosovës në Hendboll, në Notvill – Zvicër, ku pritet të udhëtojë më datë 15.10.2021 dhe të kthehet më 18.10.2021.

Arta Ismajli

Drejtoreshë e DKRS-së



KHF " Vushtrria"

Vushtrri

Të nderuar,

Në emër të Klubit të Hendbollit Femrat "Vushtrria"-Vushtrri, parashtrojm një kërkesë pranë kësaj Drejtorie për mbështetje financiare prej 9,000,00 (nëntë mij euro) në emer të shpenzimeve me rastin e udhtimit jashtë vendit konkretisht në shtetin e Zviccrës në qytetin Notvill për zhvillimin e dy ndeshjeve në kuadër të EHF CUP. Klubi ynë në këtë garë paraqitet si Kampione e Kosovës në Hendboll për Femra, Kjo shumë nevojitet për aplikimin për viza, dhe bileta për udhtimë për të gjithë stafin e Klubit i cili pritet të udhtoj me datën 15,10,2021 dhe të mbërrij në Prishtinë me 18,10,2021.

Shpresojm të kemi mirkuptimin tuaj.

Me respekte KHF" VUSHTRRIA" - VUSHTRRI

17/09/02021

